



REPUBLIKA E SHQIPEISE  
PREFEKTI I QARKUT FIER

# ANALIZA VJETORE 2024



3 Shkurt 2024



[Prefekti.Fier@mb.gov.al](mailto:Prefekti.Fier@mb.gov.al)



<http://prefektifier.gov.al/>

## PËRMBAJTJA

<b>RAPORTIM DHE INFORMIM NË USHTRIM TË FUNKSIONIT TË PREFEKTIT TË QARKUT FIER .....</b>	<b>2</b>
<b>SEKTORI JURIDIK.....</b>	<b>6</b>
<b>KOMITETI RAJONAL ANTITRAFIKIM / KRAT .....</b>	<b>14</b>
<b>KOMITETIT RAJONAL PËR PARANDALIMIN E RADIKALIZMIT DHE LUFTËS KUNDËR EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM.....</b>	<b>14</b>
<b>SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE DHE FUNKSIONEVE TË DELEGUARA .....</b>	<b>15</b>
<b>SEKTORI I FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE .....</b>	<b>24</b>
<b>SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN .....</b>	<b>32</b>
<b>SEKTORI I PLANIFIKIMIT DHE MBROJTJES CIVILE.....</b>	<b>40</b>
<b>VEPRIMTARIA “PËR LUFTËN KUNDËR KANABISIT”.....</b>	<b>42</b>
<b>OBJEKTIVAT PËR VITIN 2025 PËR INSTITUCIONIN E PREFEKTIT TË QARKUT FIER.....</b>	<b>43</b>

## **RAPORTIM DHE INFORMIM NË USHTRIM TË FUNKSIONIT TË PREFEKTIT TË QARKUT FIER**

Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier në përmbushje të misionit dhe ushtrimit të përgjegjësive gjatë vitit 2024, u fokusua jo vetëm në forcimin e rritjes së rolit të Institucionit bazuar në ligjin për Prefektin e Qarkut, por edhe në forcimin dhe bashkëpunimin real me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, Degët Territoriale, Policinë Vendore. Veprimtaria e Institucionit u përshkua nga vijimësia e standardizimit, funksionimit të qasjes të marrëdhënieve midis Institucionit të Prefektit të Qarkut në raport me Ministrinë dhe Institucionet e tjera Qendrore ,me Degët Territoriale që veprojnë në qark dhe NJVQV, në drejtimet:

-Rritja e rolit të Prefektit në konsolidimin e imazhit të institucionit nëpërmjet menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

-Bashkpunim në rritjen e performancës së punonjësve të administratës shtetërore brenda çdo institucioni apo degë territoriale.

Kjo duke u bazuar dhe mbështetur në zbatimin me përpikmëri të:

Ligjit 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut, ligj i cili ka përcaktuar rolin e prefektit si përfaqësues të Këshillit të Ministrave në qark, si garantues i zbatimit të programit të qeverisë në nivel qarku, përgjegjësitë dhe kompetencat e tij për realizimin e këtij misioni;

-Programi i Qeverisë 2021-2025 program i cili në zbatimin e tij, kërkon impenjim, bashkëpunim, koordinim maksimal të këtij institucioni për zbatimin me sukses të reformave të miratuara , si dhe për arritjen e objektivave të vendosura nga qeveria Rama 3.

Institucioni i Prefektit qarku Fier gjatë vitit 2024, ka ndjekur, monitoruar e shqyrtuar veprimtarinë e institucioneve qendrore në nivel vendor, duke bashkërenduar punën, për realizimin e detyrave në përputhje me programin e qeverisë; ka rritur kërkesat ndaj vetes dhe Institucioneve në fjalë duke intensifikuar punën dhe bashkëpunimin me institucionet qendrore në nivel vendor, me Njësitë e vetëqeverisjes vendore, organizatat dhe shoqatat e ndryshme që ushtrojnë aktivitet brenda territorit të qarkut, nëpërmjet shkëmbimeve shkresore, takimeve me drejtues të institucioneve dhe drejtues të NJVV, ndjekjen e problematikave dhe jo vetëm, me qëllim krijimin e urave bashkëpunuese dhe ndërvepruese për zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë kësaj periudhe.

Gjatë vitit 2024, institucioni i Prefektit të qarkut, ka punuar në vijimin e standardizimit të mënyrës së hartimit të urdhrit, shkresës, trajtimit të kërkesave dhe ankesave, dorëzimit të dokumentacionit të prapambetur në AQV, ruajtjen e dokumenteve shkresore, monitorimin e ecurisë së sistemit të dokumentacionit arkivor në vite.

Rritjen e bashkëpunimit midis Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, Inspektorateve Shtetërore, Drejtorisë Vendore të Policisë së Qarkut me qëllim parandalimin dhe identifikimin e autorëve në veprat penale si zjarrvënie e qëllimshëm, kultivimi i lëndëve narkotike, prerja e pyjeve, etj.

Hartimin e Planit të Menaxhimit të Emergjencave Civile në shkallë qarku, bazuar në ndryshimet ligjore e udhëzimet e ardhura nga AKMC, duke i kushtuar rëndësi të veçantë analizës së riskut, llogaritjes së forcave dhe mjeteve (të strukturave vendore, strukturave qendrore dhe të të tretëve) dhe skenarëve të ndryshëm sipas probabilitetit të ndodhjes.

---

L. “11 Janari” Rr. “Ramis Aranitasi” Fier, <http://prefektifier.gov.al>, [prefekti.fier@mb.gov.al](mailto:prefekti.fier@mb.gov.al)

-intensifikimin e punës për bashkëpunimin real dhe konkret me strukturat përkatëse për parandalimin, menaxhimin, rehabilitimin e pasojave në rastet e emergjencave civile, drejtimin e task forcave, kontrollin dhe monitorimin e zbatimit në nivel qarku të politikave sektoriale të Këshillit të Ministrave në bujqësi, arsim, shëndetësi, mjedis, rend publik, shërbim zjarrfikës, ndihmë dhe përkrahje sociale, turizëm dhe kulturë.

Institucioni i Prefektit të qarkut ka bashkërenduar dhe ka siguruar mbështetjen e ndërsjellët të organeve të Policisë së Shtetit, të institucioneve shtetërore në nivel vendor dhe të organeve të Vetëqeverisjes Vendore, për marrjen e masave për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike në nivel qarku.

**Të gjitha këto bazuar në objektivat e përcaktuara dhe miratuara nga ana e Prefektit për Institucionin tonë për vitin 2024 të cilat janë:-**

**1-Rritja dhe konsolidimi i frymës institucionale** gjatë procesit të verifikimit të ligjshmërisë së akteve me karakter normativ me organet e vetëqeverisjes vendore duke synuar përmirësimin e cilësisë së vendimmarrjes të njësisë të vetëqeverisjes vendore dhe përmirësimin e procesit të verifikimit të ligjshmërisë nga Institucioni i Prefektit të Qarkut.

**2-Ndjekja e proceseve gjyqësore** në të gjitha shkallët e gjykimit me përgjegjshmëri, efikasitet dhe në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi.

**3-Rritja e standardit ligjor të hartimit** të shkresave nga administrata si dhe dhënia e asistencës juridike NJVQV-ve për korrigjimin e problematikave të konstatuara gjatë verifikimit të ligjshmërisë së akteve.

**4-Perdorimi dhe menaxhimi me ekonomi efektivitet dhe efikasitet të fondeve buxhetore**  
Realizimit të këtij objekti do t'i shërbejë:

- a) hartimi i një plani të detajuar të burimeve financiare sipas klasifikimit buxhetor, bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", .
- b) Studimi I hollësishëm i nevojave dhe kërkesave sipas sektorëve për fonde, për vitin 2023, duke bashkëpunuar me sektorët, në respektimin e parimit të transparencës , ligjshmërisë , shmangien e shpërdorimit të fondeve, keqpërdorimit, dhe vjedhjes së pasurisë së institucionit.
- c) bashkëpunimi me ministrinë e linjës dhe departamentin e Administratës Publike
- d) Mirëmbajtja e aktiveve të Institucionit, rritja e përgjegjësisë menaxheriale të Sektorit të Financës dhe shërbimeve mbështetëse.

**5-Permiresim i Kushteve të punës**

- Përmirësimi i kushteve të punës, në këndvështrimin jetësor dhe atë funksional.
- Kompletimi i zyrave me orënditë e nevojshme.
- Pajisja me bazë materiale të përditshme.
- Standardizimi i sistemimit të dokumentacionit në zyra dhe kujdesit për ambientin e punës.
- Zbatimi i kodit të etikës në punë etj,
- Mirëmbajtja e aktiveve të Institucionit, rritja e përgjegjësisë menaxheriale të Sektorit të Financës dhe shërbimeve mbështetëse.

**6-Arkivimi i dokumenteve**

- a) Standardizimi dhe sistemimi i dokumentacionit arkivor të Institucionit të Prefektit të Qarkut Fier

- b) Standardizimi i mënyrës së hartimit të urdhrit, vendimit, udhëzimit, trajtimit të kërkesave ankesave, kthim përgjigjeve etj.
- c) Zbatimi me rigorozitet i gjuhës shqipe dhe përmirësimit të mënyrës së formulimit të dokumentit.
- d) Përpunimi dhe dorëzimi i dokumentacionit arkivor në vite.
- e) Përmirësimi i kushteve të ambientit të përpunimit të dokumentacionit shkresor ditor të arkivit.

**7- Ndjekja dhe zbatimi i procedurave ligjore** mbi menaxhimin e burimeve njerëzore në lidhje me legjislacionin për nëpunësin civil, emërimin, lirim, rekrutimin, regjistrimin e lëvizjes së punonjësve, menaxhimin e dosjeve të personelit dhe dhënies së informacioneve eprorëve sipas shkallës së hierarkisë, mbi menaxhimin e burimeve njerëzore. (Raportimi periodik/mujor i informacionit në lidhje me lirimet, emërimet, vlerësimet, masat disiplinore, proceset gjyqësore të nëpunësve civil), duke iu referuar strukturës plan dhe asaj fakt, shpallja e vendeve vakante sipas kriterëve, përshkrimeve dhe arsimit të kërkuar, sipas aftësive profesionale, dhe kriterëve të përcaktuara, në aktet ligjore, nënligjore, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike dhe me Ministrinë e Brendshme.

*Administrimi i HRMIS*, hedhja e të dhënave dhe shkresave nga dosja personale fizike në sistemin online.

**8- Raportimi dhe përditësimi i pronave të paluajtshme** sipas listës së inventarit të pronave për Institucionin e Prefektit Qarkut Fier bazuar në VKM nr. 28, datë 27.1.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve”, si dhe urdhrit të Ministrit të Brendshëm nr. 44, datë 11.4.2023 për zbatimin e VKM nr. 28, datë 27.1.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve”, do të realizohen nëpërmjet veprimtarive si me poshtë:

- a. Garantimin para miratimit të shkresave/urdrave me karakter financiar, lidhur me ligjshmërinë, rregullshmërinë dhe respektimin e parimeve të ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit; përgatitjen e dokumentit përfundimtar të buxhetit dhe bashkërendimin e punës gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit dokumentimin e të gjitha transaksioneve financiare dhe të tjera dhe garantimin e gjurmës së auditimit për të gjitha proceset që ndodhin në njësi; pranimin ose jo të dokumentacionit, bazuar në kontrollin pas faktit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
- b. Mbajtjen dhe zbatimin e sistemit të kontabilitetit, raportimit për vendimmarrjen, në funksion të realizimit të objektivave, kontabilizimin e plotë, të saktë dhe në kohë të të gjitha transaksioneve,
- c. Kontrollin dhe ndjekjen e shpenzimeve dhe të ardhurave të Institucionit, përpilimin e evidencës së shpenzimeve faktike mujore dhe progresive paraqitjen të Titullari i Institucionit dhe dërgimin në Ministrinë e linjës.
- d. Kontrollin mbi ndjekjen dhe pasurimin e dosjes së personelit, duke bërë në të ndryshimet përkatëse në bazë të urdhërave dhe vendimeve për lëvizje, dhënie stimulesh dhe masash disiplinore, mbarim shkolle dhe kurse, duke vendosur në pjesën përkatëse vlerësimet periodike të punës së nëpunësit, Marrjen e masave për njohjen dhe zbatimin me përpikmëri të ligjeve dhe akteve nënligjore të “Nëpunësit të shërbimit civil” dhe punonjësve që rregullohen me kodin e punës

- e. Kontrollin mbi Regjistrimin e korrespondencës zyrtare, shpërndarjen dhe përpunimin e tyre, evidentimin, ruajtjen fizike, përpunimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve në bazë të ligjeve në fuqi.
- f. Kontrollin mbi Protokollimin e vendimeve dhe urdhërave e Prefektit të Qarkut Fier, si dhe praktikën shkresore të Prefektit të Qarkut Fier nënshkruar nga Prefekti i Qarkut Fier apo persona të tjerë të autorizuar me urdhër të veçantë me shkrim prej tij.
- g. Koordinimin, Administrimin dhe mirëmbajtjen e ambienteve të punës, pajisjeve teknike, për krijimin e kushteve sa më të përshtatshme të punës për të gjithë punonjësit.
- h. Organizimin e punës mbi Përgatitjen e kërkesave, që lidhen me bazën e nevojshme materiale për mirëmbajtjen ose riparimin e godinës, të printerave, të fotokopjeve, të fakseve, të automjeteve, të sistemit të ndriçimit dhe të pajisjeve kancelarike.
- i. Përgatitjen e kushteve dhe specifikimet teknike për pranimin dhe lëvrimin e mallrave, magazinimin dhe ruajtjen e tyre;
- j. Ruajtjen, sistemimin dhe administrimin e dosjeve dhe librezave të punës së punonjësve që janë ose merren në punë në Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier duke bërë inkuadrimin e tyre sipas sistemit (HRMIS)
- k. Ndjekjen e shërbimit të pastrimit dhe higjienizimit të zyrave, përfshi edhe pajisjet brenda tyre, ambienteve të brendshme e të jashtme të godinës së Institucionit çdo ditë dhe gjatë gjithë orarit zyrtar të punës
- l. Mbajtjen në gatishmëri të vazhdueshme teknike mjetet e transportit, dhe kontrolli i shpenzimeve të karburantit për të kryer shërbimin e transportit të punonjësve të administratës në përmbushje të detyrave të tyre funksionale.

## **9-Hartimi dhe miratimi i planit të Emergjencave Civile, në nivel qarku**

Përmbushja e detyrime ligjore të parashikuar në ligjin Nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile” dhe plotësimi me setin e domosdoshëm të dokumentacionit për “Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë.

**10-Sigurimi i funksionimit të sistemit të paralajmërimit të hershëm, monitorimit dhe njoftimit në nivel qarku.** Rritja e bashkëpunimit me strukturat qendrore dhe vendore të mbrojtjes civile për identifikimin, mbledhjen, përpunimin, analizimin dhe komunikimin e të dhënave që kanë të bëjnë me rreziqet e menjëhershme dhe ato të pritshme.

## **11- Konsolidimi i performancës së strukturave vendore të mbrojtjes civile**

Konsolidimi i performancës së Drejtorive/ Sektorëve të Menaxhimit të Emergjencave Civile (MC) në Qark, nëpërmjet një veprimtarie të përbashkët për të ndikuar në mënyrë reciproke në rritjen dhe konsolidimin e performancës në drejtim të parandalimit, planëzimit dhe menaxhimit të situatave emergjente.

Për realizimin e këtyre objektivave u punua nga çdo sektor, pjesë e Administratës së Prefektit të qarkut Fier.

Konkretisht”

## **SEKTORI JURIDIK**

### **❖ Objektivat e Sektorit juridik Prefekti I Qarkut Fier, realizimi I tyre Janar-Dhjetor 2024.**

- 1- Rritja dhe konsolidimi i frymës institucionale gjatë procesit të verifikimit të ligjshmërisë së akteve me karakter normativ me organet e vetëqeverisjes vendore duke synuar përmirësimin e cilësisë së vendimmarrjes të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe përmirësimin e procesit të verifikimit të ligjshmërisë nga Institucioni i Prefektit të Qarkut. (objektiv vjetor)
- 2- Ndjekja e proceseve gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit me përgjegjshmëri, efikasitet dhe në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi. (objektiv vjetor)
- 3- Rritja e standartit ligjor të hartimit të shkresave nga administrata si dhe dhënia e asistencës juridike NJVQV-ve për korrigjimin e problematikave të konstatuara gjatë verifikimit të ligjshmërisë së akteve. (objektiv vjetor)
- 4- Rritja e standardit ligjor të veprimtarisë së sektorit juridik. (objektiv vjetor).

Në përmbushje të këtyre objektivave sektori juridik punoi në:

#### **➤ Verifikimin ligjor të akteve të NJVQV-ve në kompetencë të prefektit.**

- Për periudhën janar-dhjetor 2024 nga gjashtë njësi të vetëqeverisjes vendore të nivelit të parë dhe një njësi e vetëqeverisjes vendore e nivelit të dytë Këshilli i Qarkut Fier, në institucionin e Prefektit të Qarkut janë depozituar dhe shqyrtuar për vlefshmëri ligjore **134** vendime të organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore. Janë verifikuar dhe konfirmuar në përputhje me ligjin **130** vendime të këshillave. Janë kthyer si vendime në kundërshtim me ligjin **4** vendime konkretisht 1 vendim Këshillit Bashkiak Patos, 1 vendim Këshillit Bashkiak Mallakastër dhe 2 vendime Këshillit Bashkiak Roskovec. Për vitin 2024 nuk ka patur vendime të kundërshtuara në gjykatë për pavlefshmëri.

Vendimet e verifikuara kanë qenë me natyrë të ndryshme si miratimi i buxheteve dhe dokumentit përfundimtar të PBA-së, paktës fiskale, rishpërndarje fondesh në buxhet, miratimi i shtesave të fondit në buxhet, miratimi i kriterëve apo standarteve që lidhen me funksionet që i kanë kaluar këshillit, miratimi i tavaneve të shpenzimeve për PBA 2025-2027,

i dokumentit të parë të PBA 2025-2027, dokumentit të rishikuar të PBA-së, përdorimin e fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile etj.

Gjatë vitit 2024 nga ana e bashkive janë miratuar një sërë planesh vendore si: “Plani social vendor” Bashkia Mallakastër; “Plani i përmisimit të shërbimit të arsimit parashkollor” Bashkia Fier; “Plani vendor i kujdesit dhe përfshirjes sociale” Bashkia Fier; “Plani social” Bashkia Divjakë; “Plani lokal i menaxhimit të zhurmave në mjedis” Bashkia Patos; “Plani lokal i veprimit për rininë” Bashkia Patos të cilat janë verifikuar dhe konfirmuar nga ana jonë.

Nga evidenca e akteve rezulton se për këtë periudhë bashkia me numrin më të madh të akteve të depozituara për verifikim ligjor është Bashkia Divjakë me 26 vendime ndërsa Këshilli i Qarkut rezulton me numrin më të vogël të vendimeve të depozituara, 6 vendime. Për vendimet e kthyera nga ana jonë është bërë argumentim ligjor. Janë mbajtur kontakte të vazhdueshme me sekretarët e këshillave të bashkive por edhe me specialistët sipas kërkesave në funksion të përmirësimit të punës në lidhje me vendimet e këshillave bashkiakë dhe bazueshmërisë së tyre ligjore. Nga ana e tij sektori juridik kur i është kërkuar ka dhënë konsulencë juridike bashkive për evidentimin e saktë të akteve me karakter normativ të cilat duhet të depozitohen nga këto të fundit për verifikim ligjor.



**Pasqyra e akteve normative të NJVQV-ve në formë progresive për periudhën janar-dhjetor 2024 është si më poshtë:**

NR	<b>Verifikimi i ligjshmërisë së akteve të organeve të vetëqeverisjes vendore për periudhën janar-dhjetor 2024</b>							
	Njësitë e vetëqeverisjes vendore	Akte të hyra tek Prefekti	Të bazuara në ligj	Të pa bazuara në ligj	Të rishqyrtuara	Verifikimi në vend i ligjshmërisë së akteve	Dërguar në gjykatë	Vendime të pa konfirmuara, në proces për kërkim informacioni
		Prog	Prog	Prog	Prog	Prog	Prog	Prog
1	Këshilli i Qarkut Fier	6	6	0	0	4	0	0
2	Bashkia Fier	20	20	0	0	18	0	0
3	Bashkia Lushnje	22	22	0	0	19	0	0
4	Bashkia Mallakastër	19	18	1	1	17	0	0
5	Bashkia Divjakë	26	26	0	0	23	0	0
6	Bashkia Patos	18	17	1	1	18	0	0
7	Bashkia Roskovec	23	21	2	2	20	0	0
<b>TOTALI</b>		<b>134</b>	<b>130</b>	<b>4</b>	<b>4</b>	<b>119</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

### **Krahasuar me një vit më parë rezulton se:**

Gjatë vitit 2024 nga ana e NJVQV-ve janë depozituar më pak akte për verifikim ligjor se gjatë vitit 2023.

Konkretisht: Për vitin 2023 janë depozituar gjithësej 138 vendime nga NJVQV-të ndërsa në vitin 2024 gjithësej 134 vendime.

Për vitin 2023 janë kthyer nga Prefekti i Qarkut si vendime në kundërshtim me ligjin 5 vendime ndërsa për vitin 2024 4 vendime.

Si gjatë 2023 edhe gjatë 2024 nuk ka patur vendime të kundërshtuara për pavlefshmëri në gjykatë.

### **❖ Verifikimi në vend i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ**

Spektori juridik ka kryer verifikimin në vend të ligjshmërisë së akteve me karakter normativ për periudhat dhjetor 2023, janar-shkurt 2024; mars – maj 2024; qershor-gusht 2024; shtator-nëntor 2024.

Verifikimi në vend është parashikuar për tu kryer në planin vjetor si dhe me urdhër të prefektit. Verifikimi është kryer çdo tre muaj si kërkesë e ligjit.

Objekt i verifikimit ka qenë edhe ecuria e vendimeve të kthyera nga prefekti si vendime në kundërshtim me ligjin.

Dokumentacioni i kërkuar për çdo bashki për verifikim ligjor ka qenë:

- Aktet e miratuara nga këshilli bashkiak për periudhën objekt verifikimi bashkë me dokumentacionin shoqërues përkatës;
- Aktet e miratuara nga Kryetari i Bashkisë për periudhën objekt kontrolli;
- Procesverbalet e mbledhjeve.

Grupi i punës ka mbajtur për cdo verifikim procesverbalin në vend si dhe ka dërguar tek cdo bashki dhe në këshillin e qarkut raportin përfundimtar mbi verifikimin e ushtruar. Grupi i punës gjatë verifikimit në vend ka dokumentuar edhe ecurinë e vendimeve të kthyera nga prefekti si vendime në kundërshtim me ligjin për periudhën objekt kontrolli. Rezulton se vendimet e kthyera si vendime në kundërshtim me ligjin, këshillat bashkiak respektiv i kanë marrë në rishqyrtim në mbledhjen pasardhëse duke i anuluar apo shfuqizuar.

***Konkretisht për periudhën janar- dhjetor 2024 janë kthyer gjithësej 4 vendime 2 vendime Bashkisë Roskovec dhe 1 vendim Bashkisë Patos dhe 1 bashkisë Mallakaster.***

- Bashkisë Roskovec i është kthyer vendimi Nr. 12, datë 19.02.2024, “Për një shtesë dhe transferime në buxhetin e vitit 2024”. Rezulton se Këshilli Bashkiak Roskovec

në mbledhjen e datës 25.03.2024 e ka marrë në rishqyrtimin vendimin Nr. 12 datë 19.02.2024 dhe e ka anuluar me vendimin Nr. 17 datë 25.03.2024.

- Vendimi Nr. 23 datë 29.03.2024 i Këshillit të Bashkisë Patos “Për dhënie e ndihmës financiare në rast fatkeqësie të shkaktuar nga rënia e zjarrit në banesë dhe humbjen e jetës së z. Sabri Serdari në fshatin Verbas, njësia Administrative Zharrës” (jo normativ) i kthyer nga ana jonë si akt në kundërshtim me ligjin është marrë në rishqyrtim nga Këshilli Bashkiak Patos në mbledhjen pasardhëse dhe është shfuqizuar me Vendimin Nr. 40, datë 30.04.2024
- Vendimi i Këshillit të Bashkisë Roskovec Nr. 48, datë 31.07.2024, “Për miratimin e përdorimit të fondit të emergjencave civile për vitin 2024” (akt jonormativ i kthyer si akt në kundërshtim me ligjin, është marrë në rishqyrtim në mbledhjen pasardhëse nga Këshilli i Bashkisë Roskovec i cili me vendimin Nr. 53, datë 29.08.2024 e ka anuluar vendimin Nr. 48 datë 31.07.2024.
- Vendimi Nr. 43 datë 25.09.2024 i Këshillit të Bashkisë Mallakastër “Për miratimin e planit social vendor 2024-2027”. Ky vendimi është marrë në rishqyrtim në mbledhjen pasardhëse dhe është anuluar me vendimin Nr. 50, datë 29.10.2024 i Këshillit të Bashkisë Mallakastër.

Rezulton se gjatë kontrollit në vend të ligjshmërisë, për periudhën janar-dhjetor 2024, **janë verifikuar 119 vendime**, verifikimi i ligjshmërisë së të cilave është në kompetencë të prefektit.

❖ **Për periudhën objekt kontrolli nuk janë gjetur akte me karakter normativ të padepozituara nga NJVQV-të për verifikim ligjor.**

❖

➤ **Për sa i përket proceseve gjyqësore.**

Gjatë periudhës janar-shtator ka patur 1 proces gjyqësor në Gjykatën e Apelit Tiranë me palë :

**PADITËSE:** Olta Zhuka

**I PADITUR:** Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier

**ME OBJEKT:** Detyrimin e palës së paditur Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier të paguajë dëmshpërblimin e tre pagave mujore për moszbatim të afatit të njoftimit, dëmshpërblimin e 2 pagave mujore për moszbatim të procedurës së zgjidhjes së marrëdhënies së punës, dëmshpërblimin e vjetërsisë në punë me 7 muaj pagë dhe 12 muaj pagë për shkak të zgjidhjes së marrëdhënies së punës pa shkak të justifikuar.

Gjykata e Shkallës së Parë Fier me vendimin Nr. 62-2020-4852-(1229) Datë 15.12.2020 ka vendosur:

1. *Pranimin pjesërisht të padisë.*
2. *Detyrimin e të paditurit Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier ti paguajë paditëses Olta Zhuka shpërblimin për vjetërsi për 11 vite pune në masën 5.5 paga mujore.*
3. *Rrëzimin e padisë për pjesët e tjera të objektit të padisë.*

Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim Prefekti i Qarkut Fier por edhe pala paditëse. Pala jonë e ka kundërshtuar vendimin vetëm për sa i përket masës së shpërblimit të vjetërisë që gjykata i ka njohur palës paditëses si dhe për shpenzimet gjyqësore. Ndërsa pala paditëse ka ushtruar ankim kundër të gjithë vendimit.

Gjithashtu gjatë vitit 2024 sektori juridik ka hartuar kërkesat për kalim procedural drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje për 2 raste:

**Në çështjen gjyqësore me palë:**

**Paditës:** Ridvan Zoto

**Të paditur:** Bajame Ruko Prefekti i Qarkut Fier etj.

**Objekt:** Konstatimin e pavlefshmërisë së aktit të marrjes në pronësi Nr. 13210 datë 04.03.2017

**Si dhe në çështjen gjyqësore me palë:**

**Paditës:** Z. Harilla Profka

**Të paditur:** Njësia Administrative Kuman, Bashkia Roskovec

Prefekti i Qarkut Fier

Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier.

**Person i tretë:** Arben Profka

**Objekti:** Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të AMTP-së Nr. 13077/2 datë 10.11.2002, në emër të Vangjel Profka, si akt i nxjerrë në kundërshtim flagrant me ligjin nga Komisioni i Ndarjes së tokës në fshatin Marinëz, Njësia Administrative Kuman. etj,

*Në të dyja rastet kemi kërkuar kalimin procedural, nga palë e paditur Prefekti i Qarkut Fier në palë të paditur ASHK Drejtoria Fier pasi sipas Ligjit Nr. 20/2020, ASHK-ja është autoriteti publik përgjegjës për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”. Prefekti i Qarkut nuk ka kompetencë të ndjek proceset gjyqësore të*

hapura nga KVVTP-ja. Dosjet me Ligjin Nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” i kanë kaluar ASHK-së.

#### **Për sa i përket detyrave të tjera:**

- Për periudhën Janar – Dhjetor 2024 nga zyrat e arkivit të gjendjes civile në Qarkun Fier është ofruar shërbim on line si vijon:
  - **Zyra e Arkivit të Gjendjes Civile pranë Prefektit të Qarkut Fier 20507 shërbime të ndryshme;**
  - **Zyra e Arkivit të Gjendjes Civile Mallakastër 3024 shërbimeve të ndryshme;**
  - **Zyra e Arkivit të Gjendjes Civile Lushnje 10455 shërbimeve të ndryshme.**
- Janë zbatuar rekomandimet e lëna nga KLSH me perjashtim të rekomandimeve që lidhen me vendimmarrjet e bashkive gjatë periudhës zgjedhore.

Plotësimi i tyre është i evidentuar edhe në planin e veprimit mbi përmbushjen e rekomandimeve të lëna nga KLSH të hartuar nga sekretari i përgjithshëm.

Nga ana e sektorit të Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara, janë ndjekur dhe zbatuar Objektivat:

- ❖ **Rritja e bashkëpunimit dhe ndërtimi i marrëdhënieve me Njësitë e Veteqeverisjes Vendore me qëllim njohjen dhe ushtrimin e kompetencave nga ana e tyre dhe evidentimin e problemeve për të cilat janë të interesuara NJVQV-të në raport me Organet e Qeverisjes Qëndrore.**

#### **Ky objektivi u realizua nëpërmjet:**

- Ofrimit të ndihmës dhe asistencës në mënyrë të vazhdueshme nga ana e Institucionit të Prefektit, organeve të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për realizimin e kompetencave, funksioneve të tyre me qëllim shtrirjen dhe zbatimin e programit qeverisës në nivel vendor, zbatimin e strategjive kombëtare dhe rajonale të miratuara, përmbushjen e parimit të decentralizimit si një proces i cili synon të përmirësojë efektivitetin e administratës publike dhe efikasitetin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët.
- Realizimit të takimeve, pjesëmarrja në aktivitete,
- Përgatitjes së raporteve lidhur me tema të caktuara që i përkasin kompetencave të NJVQV-ve.
- Dhënies së ndihmës proactive në formën e kërkuar, për realizimin e funksioneve dhe kompetencave të tyre .

Veprimtaria e Institucionit të Prefektit ka si mision përmbushjen e detyrimeve të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” nenin nr.15 që përcakton:

*1.Ndërmjet prefektit të qarkut dhe organeve të vetëqeverisjes vendore nuk ka marrëdhënie varësie.*

*2. Marrëdhëniet ndërmjet prefektit të qarkut dhe organeve të vetëqeverisjes vendore bazohen në parimin e konsultimit dhe të bashkëpunimit për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta.*

**Konkretisht:**

- Është realizuar komunikimi me Institucionet shtetërore dhe NJVQV-të për çështje specifike sipas rastit në varësi të korrespondencave të caktuara
- Është kërkuar informacion lidhur me planin e të ardhurave sipas kategorive të taksave
- Është kërkuar informacion lidhur me aktivitetet dhe evenimentet
- Ndjekja e aktiviteteve për dhunën në familje, dhunën ndaj grave dhe trafikimin e qenieve njerëzore. Takimet :
  - Më datë 12.04.2024 pjesëmarrje në takim e organizuar pranë Qendrës Sociale Komunitare Roskovec për rastin e një të miture.
  - Më datë 15.04.2024 pjesëmarrje në takim e organizuar pranë Qendrës Sociale Komunitare Roskovec për rastin e një të miture.
  - Më datë 18.06.2024 pjesëmarrje në takim e organizuar pranë Qendrës Sociale Komunitare Roskovec për rastin e një të miture.
  - Më datë 15.08.2024 pjesëmarrje në takim e organizuar pranë Qendrës Sociale Komunitare Roskovec për trajtimin e rasteve të dy të miturave.
  - Më datë 13.09.2024 pjesëmarrje në takim e organizuar pranë Qendrës Sociale Komunitare Roskovec për rastin e një të miture.
  - **Në total 5 takime.**

## **KOMITETI RAJONAL ANTITRAFIKIM / KRAT**

- Takimet e Komitetit Rajonal Antitrafikim / KRAT-it u realizuan në datat :
  - 30.01.2024
  - 27.03.2024
  - 26.06.2024
  - 25.09.2024
  - 07.11.2024

Informacioni për këto takime, është dërguar tek Koordinatorit Kombëtar Antitrafikim.

**Në kuadër të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore, janë evidentuar:**

- 16 (gjashtembedhjet rast për Trafikim të Personave të Rritur , parashikuar nga neni 110/a i K.Penal.
- 7 (Shtate) raste per Trafikim i te Mitureve, parashikuar nga neni 128/b i K.Penal.
- 10 (dhjete) raste për Trafikim Personash drejte BE-se (Dhënia Ndhimë për Kalim të Paligjshëm të Kufirit) , parashikuar nga neni 298 i K.Penal.

## **KOMITETIT RAJONAL PËR PARANDALIMIN E RADIKALIZMIT DHE LUFTËS KUNDËR EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM**

- Takimet e Komitetit Rajonal për Parandalimin e Radikalizmit dhe Luftës Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, u realizuan në datat :
  - 31.01.2024
  - 26.06.2024
  - 26.09.2024
  - 26.12.2024

*Gjatë vitit 2024, nuk ka pasur raste të ekstremizmit të dhunshëm.*

Informacioni për këto takime, është dërguar tek Koordinatorit Kombëtar për Ekstremizmin e Dhunshëm.

## **SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE DHE FUNKSIONEVE TË DELEGUARA**

- ❖ **Zhvillimi i marrdhënieve, midis Institucioneve të pavarura dhe Institucioneve të varësisë në Qark si dhe Institucioneve qendrore të qeverisë , Ministritë, KM, etj me qëllim koordinimin e tyre për realizimin e objektivave qeveritare dhe startegjive të miratuara në drejtim të funksioneve në fushën e sigurisë publike, fushën e zhvillimit ekonomik vendor, në fushën e bujqësisë, natyrës dhe biodiversitetit, në fushën e kulturës, sportit, shërbimeve argëtuese etj, si dhe në drejtim të kompetencave të deleguara pranë pushtetit vendor duke adresuar çdo pengesë dhe problematikë në zbatimin e detyrave.**

### **Ky objektivi u realizua nëpërmjet:**

- krijimit të mundësive për një bashkëpunim më të mirë dhe më të frytshëm ndërmjet Institucioneve në nivel horizontal dhe vertikal në mënyrë që problematikën të zgjidheshin dhe të mos krijohen mbivendosje kompetencash, mosmbulim të funksioneve të sipërpërmendura apo moskoordinim të tyre
- Kontrollit dhe monitorimit të veprimtarisë së Degëve Territoriale në Qark.
- Hartimit të raporteve të monitorimit të Degëve Territoriale në Qark

### **Konkretisht:**

- Analizimi i veprimtarive vjetore 2023 të Degëve Territoriale dhe adresimi i problematikave të konstatuara Ministrive përkatëse.
- Është kërkuar dhe përpunuar informacion mujor për veprimtarinë e Degëve Territoriale në Qark dhe janë ndjekur evidencat e dërguara nga degët territoriale.
- Janë hartuar materialet informative Ministrisë së Brendshme
- Është kërkuar informacion për subvencionimin e naftës në bujqësi
- Kemi ndjekur Paketën e Sigurisë në shkollë. Paketa e Sigurisë në Shkollë ka në përmbajtjen e saj këto elementë:
- **Siguria publike**

Vendosja e perimetrit të sigurisë në shkollë qofshin ato hapësira fizike përreth shkollave, ku fëmijët qëndrojnë, ndërveprojnë dhe kalojnë pjesë të kohës së tyre para apo pas mësimit e që përfshijn rrugët dhe rrugicat përreth kufijve të shkollës si dhe të gjitha aktivitetet tregtare (dyqane, kioska, njësi biznesi) që ushtrohen brenda kësaj hapësire.

- **Siguria rrugore**

Vendosja dhe mirëmbajtja e sinjalistikës rrugore, vertikale dhe horizontale, dhe semaforëve të nevojshëm brenda Perimetrit të Sigurisë së shkollave.

- **Siguria ushqimore**

Kontrolle të shtuara në të gjithë territorin e Qarkut, në operatorët e shërbimit ushqimor të kategorive të ndryshme që veprojnë në Perimetrin e Sigurisë së shkollave lidhur me kushtet e sigurisë ushqimore.



## - Siguria urbane

Kjo është pika e paketës që lidh IKMT me bashkitë për të gjitha ndërtesat që ndodhen pranë shkollave.

## - Higjena dhe duhani në shkolla

Paketa përmbante kufizime për ndalimin e duhanit jo vetëm brenda ambientit të shkollave, por në të gjithë perimetrin e sigurisë. Kjo punë është kryer nga Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor, i cili do të bëjë njoftimet për ndalimin e tregtimit të këtyre produkteve. Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor ka kryer gjithashtu edhe kontrollin higjeno-sanitar në shkolla.

- Gjatë vitit 2024 të gjithë institucionet përgjegjëse për implementimin e paketës së sigurisë në shkolla u angazhuan maksimalisht për realizimin e detyrave specifike që ju ishin ngarkuar. Nuk mungoi bashkëpunimi ndërmjet tyre për arritjen e objektivave të caktuar dhe zgjidhjen e problematikave me interes të përbashkët në dobi të komunitetit. Institucionet përgjegjëse ishin: Drejtoria Rajonale e Arsimit parauniversitar Fier, Zyra Vendore Arsimore Fier, Zyra Vendore Arsimore Lushnje, Zyra Vendore Arsimore Divjakë, Zyra Vendore Arsimore Mallakastër, Zyra Vendore Arsimore Patos, Zyra Vendore Arsimore Roskovec, Bashkia Fier, Bashkia Lushnje, Bashkia Mallakastër, Bashkia Divjakë, Bashkia Patos, Bashkia Roskovec, Drejtoria Vendore e Policisë Fier, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor.

Konkretisht veprimtaria e tyre:

### **ZVAP FIER**

Numri total i rasteve të raportuara rreth problematikave dhe incidenteve në shkollë ka qënë 27 nga të cilat kryesisht dominojnë rastet e dhunës fizike dhe verbale midis bashkëmoshatarëve për motive të dobëta (8 raste të raportuara).

Konfliktet midis nxënësve dhe personave të jashtëm në forma fizike dhe verbale që kanë cënuar sigurinë e nxënësve në shkollë (5 raste të raportuara).

Dhuna fizike ku janë përdoruar mjete të forta (3 raste të raportuara).

Raste të ngjarjeve të dhunshme prej prindërve të cilët kanë cënuar nxënësit por edhe vet fëmijët e tyre në raste specifike (3 raste të raportuara).

Përdorimi i sendeve dhe mjeteve të identifikuar si armë të ftohta në situata konfliktuale (3 raste të raportuara).

Fenomeni i duhanpirjes dhe përdorimi i lëndëve të tjera narkotike në ambientet e shkollës (2 raste të raportuara).

Fenomeni i bullizimit midis bashkëmoshatarëve (4 raste të raportuara)

Dëmtimi i mjediseve dhe objekteve të shkollës prej nxënësve (1 rast i raportuar)

### **ZVAP Lushnje**

- Gjatë gjithë vitit shkollor janë trajtuar gjithsej 9 raste të cilat kanë qenë të natyrave të ndryshme.
- ✚ Sugjerim: *Të kontribuojmë në ndërgjegjësimin për rregullat, ligjin dhe drejtesinë nëpërmjet takimeve informuese me nxenesit, si dhe bashkëpunimin me agjensite ligjzbatuese të cilat janë: Drejtoria e shkollës, Zyra Vendore Arsimore Parauniversitare Lushnje, Komisariati i Policisë Lushnje, Spz, Zyra e mbrojtjes së fëmijëve pranë Bashkisë Lushnje, me qellim parandalimin e veprave kriminale.*

### **ZVAP Mallakastër**

- Nga shkollat e ZVAP Mallakastër janë trajtuar 5 raste në bashkëpunim me punonjësit e policisë, OS dhe SHPS.
- Problematikë kryesore paraqitet menaxhimi i nxënësve në pushimin e gjatë (sidomos në shkollat e qytetit), por gjatë kësaj kohe gjithmonë ka qenë prezent patrulla e policisë e cila ka bërë të mundur sigurinë e nxënësve gjatë lëvizjeve jashtë ambienteve të shkollave. Gjithashtu mungesa e OS dhe SHPS, pasi në ZVAP Mallakastër vetëm dy gjimnaze kanë OS, ndërsa SHPS-ja nga 7 punonjës aktualisht janë vetë tre të cilët ofrojnë këtë shërbim për të gjitha shkollat.
- ❖ **Sfidat** me të cilat u përballën: Nisma që në fillim u vlerësua maksimalisht nga shkollat të gjithë aktorët e përfshirë në zbatimin e saj ka qenë bashkëpunues në zbatimin e saj.
- ✚ **Sugjerime** për vitin e ardhshëm shkollor është vendosja e OS edhe në shkolla të tjera (sidomos në ato shkolla me numër të madh nxënësish).

### **ZVAP Patos**

- Nga shkollat e ZVAP Patos janë trajtuar 7 raste në bashkëpunim me punonjësit e policisë, OS dhe SHPS.
- Problematikë kryesore paraqitet menaxhimi i nxënësve në pushimin e gjatë, sjellja e nxënësve me karakter të vështirë (sidomos në shkollat e qytetit), bullizëm në rrjetet sociale në emër të shkollës.
- ❖ **Sfidat** me të cilat u përballën: Nisma që në fillim u vlerësua maksimalisht nga shkollat, të gjithë aktorët e përfshirë në zbatimin e saj kanë qenë bashkëpunues në zbatimin e saj.
- ✚ **Sugjerime** për vitin e ardhshëm shkollor është vendosja e OS edhe në shkolla të tjera (sidomos në ato shkolla me numër të madh nxënësish).

### **ZVA Divjakë**

Në kuadër të zbatimit të sigurisë në shkolla, ZVAP Divjakë ka zhvilluar pa probleme vitin shkollor.

### **ZVAP Roskovec**

Nisma Paketa e sigurië në shkollë ishte një element thelbësor për IA-të për parandalimin e dukurive negative, si brenda ashtu edhe jashtë mjediseve të shkollës. Paketa e sigurisë në shkolla nxiti ndërveprimin e nxënësve dhe të rinjve me policinë, si dhe rrit besimin dhe komunikimin me ta. Në ZVAP Roskovec institucionet arsimore parauniversitare zhvilluan

veprimtari ndërgjegjësimi për paketën e sigurisë në shkolla për të parandaluar luftën kundër dukurive të tilla, si episode të dhunës, përdorimi i drogave dhe substancave abuzive, dukuria e bullizmit, siguria fizike në shkolla etj. Oficeri i sigurisë në shkollë luajti një rol të rëndësishëm, zhvilloi takime periodike me prindër, me stafin pedagogjik të shkollës për evidentimin e problematikave dhe diskutimin e zgjidhjeve për sigurinë në shkollë.

## **BASHKIA FIER**

Mbështetur në ligjin Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", ligjin nr. 89, datë 22.12.2022 "Për Policinë Bashkiake" Rregullores Kuadër të Policisë Bashkiake si dhe shkresës nr. 9298, datë 04.09.2023 "Paketa e Sigurisë në Shkolla", në institucionet arsimore të Bashkisë Fier, procesi ka vijuar normalisht dhe nuk janë raportuar problematika të cilat përbëjnë objekt për cënimin e sigurisë dhe mbarëvajtjes së procesit të punës.

## **BASHKIA LUSHNJE**

- Në kuadër të zbatimit të Paketës së Sigurisë, në institucionet arsimore, në institucionet e shërbimit, kopshtet me drekë dhe çerdhet, në territorin e Bashkisë Lushnje, procesi ka vijuar normalisht dhe nuk janë raportuar problematika të cilat përbëjnë objekt për cënimin e sigurisë dhe mbarëvajtjes së procesit të punës.
- Rastet të cilat janë trajtuar kanë të bëjnë më shumë me shitësit ambulantë pranë institucioneve arsimore të cilët nuk kanë zbatuar distancën e kërkuar (tre raste). Për problematika të natyrave të tjera janë institucionet përkatëse që kanë dokumentuar rastet.
- ❖ Problematikat kryesore nuk mund ti grupojmë me saktësi sepse i përkasin natyrave të ndryshme dhe duhet të shtrihet ky proces dhe jashtë institucioneve arsimore dhe perimetrit të sigurisë.
- ✚ Shumë i rëndësishëm është bashkëpunimi mes të gjitha institucioneve dhe agjensive nga njëra anë dhe strukturave shoqërore, bordeve të prindërve dhe të gjithë shoqërisë në tërësi që të mos anashkalohej asnjë detaj qoftë dhe i parëndësishëm në pamje të parë.

## **BASHKIA MALLAKASTËR**

Në kuadër të zbatimit të masave të Paketës së sigurisë në shkolla Policia Bashkiake Mallakastër në bashkëpunim me komisariatit e Policisë Mallakastër ka ndjekur procesin mësimor në shkolla, si dhe procesin e provimeve të maturës shtetërore dhe provimeve të lirimimit të shkollave 9-vjeçare. Gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur probleme shqetësuese.

## **BASHKIA DIVJAKË**

Në Bashkinë Divjakë procesi në gjithë shkollat ka vijuar normal pa problematika.

## **BASHKIA PATOS**

Në Bashkinë Patos procesi në gjithë shkollat ka vijuar normal pa problematika.

## **BASHKIA ROSKOVEC**

Në kuadër të zbatimit të Paketës së Sigurisë, në institucionet arsimore, në kopshtet me drekë dhe çerdhet, në territorin e Bashkisë Roskovec, procesi ka vijuar normalisht dhe nuk janë

raportuar problematika të cilat përbëjnë objekt për cënimin e sigurisë dhe mbarëvajtjes së procesit të punës.

## **AKU**

AKU ka kryer në total 26 inspektime në kuadër të paketës së sigurisë në shkolla.

## **DREJTORIA VENDORE E POLICISË**

- Lidhur me zbatimin e planit të masave të Paketës së Sigurisë, nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier, janë raportuar, trajtuar dhe referuar në prokurori 14 raste ku janë përfshirë nxënës shkollash.
- Problematika të cilat përbëjnë objekt për cënimin e sigurisë dhe mbarëvajtjes së procesit të punës vecojmë:
  1. Mungesa e sinjalistikës rrugore përpara dhe përreth perimetrit të shkollave,
  2. Mungesa të sistemit të kamerave të sigurisë sipas përcaktimeve si dhe
  3. shitësit ambulantë të pakontrolluar që operojnë pranë disa shkollave.

## **INSPEKTORIATI SHTETËROR SHËNDETËSOR**

Në kuadër të zbatimit të Paketës së Sigurisë në Shkolla, ISHSH Rajonal Fier ka kryer 80 monitorime në subjekte brenda perimetrit të sigurisë rreth shkollave për zbatimin e ligjit antiduhan dhe ligjit Nr.9518, datë 18.06.2006 “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit, pijeve energjike dhe pijeve me gaz të shtuar”, i ndryshuar. Nuk janë hasur problematika.

- **Prefekti i Qarkut ngriti një grup pune për të kryer monitorimin në shkollat e qytetit dhe fshatit në të gjashta bashkitë lidhur me 3 elementë:**
  - a. Vendosjen e sinjalistikës së plotë rrugore, vertikale dhe horizontale pranë çdo institucioni të arsimit parauniversitar, privat dhe publik.
  - b. Vendosjen e kamerave të sigurisë në të gjithë perimetrin e sigurisë në shkolla.
  - c. Vendosjen e pajisjeve për shuarjen e zjarrit dhe marrjen e masave ndërgjegjësuese për shmangien e rrezikut nga zjarri në shkolla.

## **ZVAP FIER**

Në total **62** shkolla qyteti. Nga këto :

- ✚ Vendosja e sinjalistikës së plotë rrugore, vertikale dhe horizontale pranë çdo institucioni të arsimit parauniversitar, privat dhe publik.

18 shkolla Po

44 shkolla Jo

- ✚ Vendosja e kamerave të sigurisë në të gjithë perimetrin e sigurisë në shkolla

21 shkolla Po

41 shkolla Jo

- ✚ Vendosja e pajisjeve për shuarjen e zjarrit dhe marrjen e masave ndërgjegjësuese për shmangien e rrezikut nga zjarri në shkolla

41 shkolla Po

21 shkolla Jo

### **ZVAP LUSHNJE**

Në total **47** shkolla. Nga këto :

- ✚ Vendosja e sinjalistikës së plotë rrugore, vertikale dhe horizontale pranë çdo institucioni të arsimit parauniversitar, privat dhe publik.

11 shkolla Po

36 shkolla Jo

- ✚ Vendosja e kamerave të sigurisë në të gjithë perimetrin e sigurisë në shkolla

04 shkolla Po

43 shkolla Jo

- ✚ Vendosja e pajisjeve për shuarjen e zjarrit dhe marrjen e masave ndërgjegjësuese për shmangien e rrezikut nga zjarri në shkolla

14 shkolla Po

33 shkolla Jo

### **ZVAP DIVJAKË**

Në total **19** shkolla. Nga këto :

- ✚ Vendosja e sinjalistikës së plotë rrugore, vertikale dhe horizontale pranë çdo institucioni të arsimit parauniversitar, privat dhe publik.

03 shkolla Po

16 shkolla Jo

- ✚ Vendosja e kamerave të sigurisë në të gjithë perimetrin e sigurisë në shkolla

00 shkolla Po

19 shkolla Jo

- ✚ Vendosja e pajisjeve për shuarjen e zjarrit dhe marrjen e masave ndërgjegjësuese për shmangien e rrezikut nga zjarri në shkolla

06 shkolla Po

13 shkolla Jo

### **ZVAP MALLAKASTËR**

Në total **26** shkolla. Nga këto :

- ✚ Vendosja e sinjalistikës së plotë rrugore, vertikale dhe horizontale pranë çdo institucioni të arsimit parauniversitar, privat dhe publik.

04 shkolla Po

22 shkolla Jo

- ✚ Vendosja e kamerave të sigurisë në të gjithë perimetrin e sigurisë në shkolla

16 shkolla Po

10 shkolla Jo

- ✚ Vendosja e pajisjeve për shuarjen e zjarrit dhe marrjen e masave ndërgjegjësuese për shmangien e rrezikut nga zjarri në shkolla

06 shkolla Po

20 shkolla Jo

### **ZVAP ROSKOVEC**

Në total **13** shkolla. Nga këto :

- ✚ Vendosja e sinjalistikës së plotë rrugore, vertikale dhe horizontale pranë çdo institucioni të arsimit parauniversitar, privat dhe publik.

12 shkolla Po

01 shkolla Jo

- ✚ Vendosja e kamerave të sigurisë në të gjithë perimetrin e sigurisë në shkolla

05 shkolla Po

08 shkolla Jo

- ✚ Vendosja e pajisjeve për shuarjen e zjarrit dhe marrjen e masave ndërgjegjësuese për shmangien e rrezikut nga zjarri në shkolla

05 shkolla Po

08 shkolla Jo

### **ZVAP PATOS**

Në total **12** shkolla. Nga këto :

- ✚ Vendosja e sinjalistikës së plotë rrugore, vertikale dhe horizontale pranë çdo institucioni të arsimit parauniversitar, privat dhe publik.

10 shkolla Po

02 shkolla Jo

- ✚ Vendosja e kamerave të sigurisë në të gjithë perimetrin e sigurisë në shkolla

02 shkolla Po

10 shkolla Jo

- ✚ Vendosja e pajisjeve për shuarjen e zjarrit dhe marrjen e masave ndërgjegjësuese për shmangien e rrezikut nga zjarri në shkolla

11 shkolla Po

01 shkolla Jo

- Është raportuar në Ministrinë e Brendshme
- Është krijuar database për task – forcën e paketës së sigurisë në shkolla
- Është raportuar cdo ditë të premte për veprimtarinë e task – forcës
- Është hartuar dhe dërguar përmbledhja e veprimtarisë pranë Ministrisë së Brendshme

- **Takimet janë realizuar në datat :**

- 26.01.2024
- 16.05.2024 Takim me oficerët e sigurisë
- 26.11.2024
  - Krijimi dhe menaxhimi grupit të ëhatssapp me oficerët e sigurisë
  - Hartimi i materialit në excel dhe dërgimi i informacionit në Ministri
  - Është kërkuar informacion DRAP dhe ZVAP lidhur me maturën shtetërore
  - Shkresë bashkisë për trajtimin e ankesës së oficerës së sigurisë shkolla “ Perikli Ikonomi”
  - Më datë 12.02.2024 kemi zhvilluar takim me DUK, AREB Lushnje, AKU me fokus veprimtarinë e tyre, objektivat dhe problematikat e hasura.
- ❖ **Ndjekja dhe monitorimi i veprimtarive të Institucioneve Qëndrore dhe Vendore për mbarëvajtjen e sezonit turistik 2022, ndjekja e detyrave nga Task-Forca të vecanta për sezonin turistik në Qark si dhe ndjekjen dhe realizimin e detyrave të Komitetit Rajonal të Turizmit. Ndjekja e problemeve të sigurisë, të higjenës dhe të shëndetësisë në plazhe dhe në zona të tjera turistike.**
  - Është realizuar koordinimi dhe është ofruar bashkëpunimi nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut bazuar në kërkesat e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për bashkëpunim me NJVQV për një mbarëvajtje sa më të mirë të Sezonit Turistik dhe për sigurimin e një sezoni të suksesshëm turistik.

### **Parqet Arkeologjike**

**Vizitueshmëria.** Nga 1 janari deri në 31.12. 2024 parku arkeologjik i Apolonisë Bylis ka patur 634 548 vizitorë, nga të cilët të huaj 82 527 të huaj.

### **Shëndetësia**

Nr.total i personave që kanë marrë trajtim në QSH. Dërmënas është 1195 dhe Nr.total i personave që kanë marrë trajtim në QSH. Divjakë është 1816

#### **AKU**

Janë kryer **428 inspektive**, nga problematikat e konstatuara në terren janë vendosur **115 masa administrative "Paralajmerim"**, **5 masa administrative gjobë në vlerën 270 000 lekë**, **2 masa administrative bllokim produkti 0.16275 ton dhe 15.6 litra produkte ushqimore**

### **ISHSH**

- Janë kryer gjithsej **66 inspektive** në subjektet Bar Restorante dhe në pishina.
  - **64 Bar restorante x 10 masa paralajmëruese dhe 1 masë administrative 100.000 leke,**
  - 2 pishina x 1 masë paralajmëruese
- Takimi i Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit u zhvillua datë 24.01.2024
  - Shkresë bashkive për procesin e lidhjes së kontratave

- Shkresë institucioneve përgjegjëse për evidentimin dhe menaxhimin e mbetjeve urbane
- Shkrese institucioneve përgjegjëse për akset rrugore që të cojnë drejt destinacioneve turistike.
- Urdhri për ngritja e task-forcës për sezonin turistik 2024 Nr.37 datë 13.05.2024
- Hartimi i planit të masave në nivel vendor/ dërguar gjithë institucioneve përgjegjëse
- Takimi i task – forcës datë 23.05.2024
- Menaxhimi i rrjetit ehatcap të task – forcës
- Raportimi në Ministrinë e Mjedisit dhe Turizmit si dhe në Ministrinë e Brendshme për veprimtarinë e task – forcës për sezonin turistik veror.
- Është krijuar database për emrat e kontaktit të task-forcës për sezonin turistik
- Janë trajtuar gjithë kërkesat për bashkëpunim kundrejt institucioneve lidhur me turizmin
- Është raportuar cdo javë në Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë për Turizmin dhe Mjedisin
- Realizuar takimi për mbylljen e sezonit turistik veror 2024
- Dërguar raporti përfundimtar në Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe Kryeministri.
- Datë 02.10.2024 takimi për mbylljen e sezonit turistik.
- Kaluam një sezon turistik të qetë dhe të suksesshëm

❖ **Realizuar 3 takime:**

- 24.01.2024 – Komiteti Rajonal i Zhvillimit të Turizmit
- 23.05.2024 – Task – Forca
- 02.10.2024 – Takimi për mbylljen e sezonit turistik

**Detyra të tjera:**

- Është mbledhur informacioni nga NJVKSH dhe është kryer raportim javor në ZOS për situatën e Covid 19 si dhe cdo situatë tjetër e krijuar
- Janë hartuar dhe plotësuar database për vdekshmërinë foshnjore dhe cilësinë e ujit të pijshëm
- Cdo ditë është bërë legalizimi i dokumentacionit për jashtë vendit. Për ndryshimet në drejtuesit e NjVQV-ve, Njësive administrative, apo punonjësit e gjendjes civile është mbajtur korespondencë dhe komunikim i vazhdueshëm. Në total janë legalizuar **3185** certifikata.( Në bashkëpunim me sektorin e mbështetjes)
- Dy punonjës janë të ngarkuar dhe ushtrojnë detyrat e Sekretariatit teknik të Komitetit Rajonal për Parandalimin e Radikalizmit dhe Luftës Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm duke zbatuar gjithë legjislacionin përkatës, duke mbledhur informacionet dhe organizuar takimet.
- Janë administruar shkresat e ardhura dhe është kryer korespondenca e nevojshme.Në total **64** shkresa .( letërnjoftime me institucionet).



- Jane administruar **65** kërkesë ankesa të qytetarëve lidhur me Institucionet. Ndjekja e problematikave në lidhje me ankesat dhe shqetësimet e qytetarëve/ Kthim përgjigje - 38 / Pa përgjigje -7.
- Azhornimet në faqen Web të Institucionit të Prefektit
- **Totali i takimeve pjesëmarrëse me tematika të ndryshme - 23**
- Kthim përgjigje Brenda afateve për gjithë email e ardhur
- Pritja dhe dhënia e informacionit për cdo qytetar që është paraqitur pranë Insitucionit.

## **SEKTORI I FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

Për realizimin e objektivit, Prefekti me urdhër, ka ngritur grupin e punës për koordinimin, plotësimin dhe shkëmbimin e informacionit të të dhënave me ekspertët e përzgjedhur nga

*Objektivat e Programit të Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse në funksion të objektivave të institucionit për periudhën janë:*

### **1.Perdorimi dhe menaxhimi me ekonomi efektivitet dhe efijence i fondeve buxhetore nëpërmjet rritjes së përgjegjesisë mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm.**

Realizimi i këtij objektivit është arritur nëpërmjet:

- a) Hartimit të planeve të detajuara të burimeve financiare sipas klasifikimit buxhetor, bazuar në Ligjin Nr. 10296 Datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndyshuar
- b) Studimit të hollësishëm të nevojave dhe kërkesave sipas sektorëve për fonde për vitin 2024, duke bashkëpunuar me sektorët në respektimin e parimit të transparencës, ligjshmërisë, shmangies së shpërdorimit të fondeve, keqpërdorimit dhe vjedhjes së pasurisë së institucionit.
- c) Kontrolleve në cdo kohë para dhe pas faktit të dokumentacionit sipas ligjeve ne fuqi.
- d) Plotësimin të strukturës sipas pozicioneve për secilin sektor.
- e) Bashkëpunimit me ministrinë e linjës dhe departamentin e Administratës Publike.
- f) Mirëmbajtjes së aktiveve të Institucionit, duke rritur përgjegjësinë menaxheriale të Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse brenda limitit të fondeve të planifikuara.
- g) Përmirësimit të kushteve të punës.
- h) Transparencës në dokumentimin e të gjitha transaksioneve financiare dhe garantimin e gjurmës së auditimit, për të gjitha veprimet financiare që kanë lindur në Institucion, hartimin e planeve mujore të punës dhe ndjekjen sistematike të realizimit të tyre, përgatitjen e analizave të punës dhe menaxhimin e burimeve njerëzore sipas *hartës së proceseve kronologjike të punës*.
- i) *Azhornimit kronologjik të veprimeve me thesarin dhe mbylljen e llogarive financiare* sipas ditarëve përkatës dhe në fund të çdo muaji rakordimi me Degën e Thesarit për situacionin e shpenzimeve dhe mbylljen e rezultatit ekonomik-financiar të Institucionit, hartimin e listë pagesave mujore të personelit, të sigurimeve shoqërore

dhe tatimit mbi pagën, ndjekjen dhe zbatimin e ligjshmërisë për problemet financiare dhe raportimi në ministritë e linjës.

- j) Pasqyrimin, rakordimit dhe verifikimit të normës së harxhimit të karburantit çdo muaj.
- k) Shërbimit higjieno-sanitar çdo ditë.
- l) Menaxhimit të burimeve njerëzore në zbatim të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, VKM Nr.833 datë 28.10.2020 ”Për Rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qëndror të personelit”, në zbatim të VKM Nr. 568 datë 06.10.2021 “Për miratimin e rregullave mbi kohëzgjatjen e punës edhe të pushimit për punonjësit e administratës shtetërore”
- m) Ndjekjes së vijueshmërisë së punonjësve dhe hartimim e listë pagesave mujore të personelit, të sigurimeve shoqërore dhe tatimit mbi pagën, ndjekja dhe zbatimi i ligjshmërisë për problemet financiare dhe përshtatja me ndryshimin e ligjeve urdhërave e udhëzimeve.
- n) Njëpërmjet bashkëpunimit me DAP.


### **Plani i buxhetit: Në/ 000 lekë**

**Buxheti total i planifikuar fillim viti është 47.733 mijë lekë, me ndryshime i planifikuar për vitin 2024 është 47. 610 mijë lekë**


- **-Të ndara sipas programeve:(buxheti fillestar)**
  - Administrata e Prefektit, plani fillestar 43.815 mijë lekë, me ndryshime 42.848 mijë lekë
  - Gjendja civile, si funksion i deleguar plani fillestar 3918 mijë lekë, me ndryshime 4762 mijë lekë.
- **Të ndara sipas llojit të shpenzimeve:**
  - Paga, shpërblime, të tjera shpenzime personeli 35.577 mijë lekë ( 75 % të fondeve e zënë pagat)
  - Kontributi i sigurimeve shoqërore 5.991 mijë lekë (12 %)
  - Mallra & shërbime të tjera (shpenzime operative) 6185 mijë lekë (13%)
  - Transferta tek individët 0 mijë lekë (0 %)
  - Shpenzime për investime 0 mijë lekë

Në mënyrë grafike pesha specifike e zërave të buxhetit ndaj totalit, paraqitet si më poshtë:

### Plani i buxhetit në % 01.01.2024




### Plani përfundimtar i buxhetit me ndryshime 31.12.2024



Programi	Artikulli	Struktura Buxhetore	Buxheti		Realizimi në datë 31.12.2024	Diferenca	Realizim i ndaj planit/ndryshime %
			Plani Fillestar 01.01.2024	Plani me ndryshime 31.12.2024			
	600	Paga, shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli	32 200	29 983	28 181	1 802	94 %
<i>Prefektura</i>	601	Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	5 430	5 430	4 673	757	86 %
	602	Mallra dhe shërbime të tjera	6 185	6 485	6 189	296	95 %
	606	Transferta tek individët	0	950	900	50	95 %
		<i>Shuma ne mije /leke Prefekti</i>	43 815	42 848	39 943	2 905	93 %
	600	Paga, shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli	3 357	4 055	3 955	100	98 %
<i>Gj. Civile</i>	601	Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	561	671	660	11	98 %
	602	Mallra dhe shërbime të tjera	0	36	36	0	100 %
	606	Transferta tek individët	0		0	0	0%
		<i>Shuma ne mije /leke, GJ.Civile</i>	3 918	4 762	4 651	111	98 %
		<b>BUXHETI TOTAL</b>	47 733	47 610	44 594	3 016	94 %

**Realizimi në total për secilin artikull për dy programet**

ARTIKULLI	STRUKTURA BUXHETORE	BUXHETI	REALIZIMI	DIFERENCA	REALIZIMI NË%
600	Paga, shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli	34 038	32 136	1902	94 %
601	Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	6 101	5 333	768	87 %
602	Mallra dhe shërbime të tjera	6 521	6 225	296	95 %
606	Transferta tek individët	950	900	50	95 %
	<b>TOTALI</b>	<b>47 610</b>	<b>44 594</b>	<b>3 016</b>	<b>94 %</b>



### Ne total buxheti eshte realizuar 94 % për të dy programet

- Shpenzimet për paga, shpërblime, shpenzime personeli, janë realizuar 94 %
- Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, 87 %
- Mallra dhe shërbime të tjera, 95 %
- Transferta tek individët, 95 %
- Investim 0 %

- Për vitin 2024 janë realizuar prokurimet: Kancelari, materiale pastrimi, siguracione të mjeteve të transportit, shërbime të ndryshme, taksa të mjeteve të transportit, shlyerja e detyrimeve për të tretët për faturat utilitare, energji, post, internet, shërbimi i rojeve private etj.

*-Është siguruar baza materiale e domosdoshme për kryerjen e aktivitetit të institucionit, si edhe kryerja e shërbimeve të tjera si ai i legalizimit të certifikatave, trajnimit të punonjësve nëpërmjet planifikimit sipas nevojave në bashkëpunim me shkollën shqiptare të administratës publike, nxjerrjes së vërtetimeve për ish-punonjësit e institucionit në vite etj., shërbime ndaj qytetarëve sipas Kërkesave.*

### ❖ Realizimi i të Ardhurave

Institucioni i Prefektit nuk gjeneron të ardhura të mirëfillta për arsye të natyrës institucionale. Të vetmet të ardhura që mund të krijoheshin janë të ardhurat e Gjendjes Civile nga taksat e pullave si funksion i deleguar në Institucionin e Prefektit të Qarkut dhe vepronjë si agjent tatimor ku 95% kalojnë nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në të ardhurat e Buxhetit të Shtetit dhe vetëm 5% i takojnë institucionit që vepron si agjent tatimor përkatësisht Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile.

Me dixhitalizimin e të dhënave të gjëndjes civile për vitin 2024 nuk kemi realizim të ardhurash nga taksa e pullës.

❖ **Përmiroshim i Kushteve të punës në këndvështrimin jetësor dhe atë funksional.**

Është punuar nga sektori i financës dhe shërbimeve mbështetëse duke bere të mundur sipas buxhetit vjetor të planifikuar për:

- Kompletimin e zyrave me orenditë e nevojshme pajisje kompjuterike (si kompjutera dhe printera)  
Eshtë bërë reformatim i disa njësive kompjuterike, janë pajisur të gjithë kompjuterat me karta rrjeti.
- Pajisja me bazë materiale të përditshme për zyrat. po kështu është kryer higjenizimi cdo ditë i ambienteve të institucionit, është kryer dhe kontrolluar dhe monitoruar në mynyrë të rregullt shërbimi i rojeve private për godinën.
- Është punuar për Standardizimin dhe sistemimin e dokumentacionit në zyra dhe në arkivë dhe vazhdimisht është ushtruar kujdesi për mirembajtjen e ambienteve të punës.
- Është punuar për Mirëmbajtjen e aktiveve të Institucionit, nëpër rritjes së përgjegjësisë menaxheriale të Sektorit të Financës dhe shërbimeve mbështetëse për secilin punonjës të institucionit.

❖ **Raportimi, saktësimi dhe përditësimi i pronave të paluajtshme sipas listës së inventarit të pronave për Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier.**

Ka qënë prioritet i punës bazuar në VKM Nr, 28, datë 27.1.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve”, si dhe urdhërit të Ministrit të Brendshëm nr. 44, datë 11.4.2023 për zbatimin e VKM nr. 28, datë 27.1.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve.

*-Është marrë Cerifikate e pronësisë e perditësuar dhe e regjistruar si një ndër pronat qeveritare me përparësi, për godinën Fier në inventar të institucionit. Është përditësuar edhe godina Lushnje por me hartë kadastrale jo përfundimtare për arsye të mos azhornimit të gjithë pronave të zonës kadastrale të ASHK Lushnje, është azhornuar statusi juridik i pronës me statusin e përdoruesit faktik të pronave të paluajtshme shtetërore për marjen e certifikatës së pronësisë pasi ishin vetem me vërtetime hipotekore.*

❖ **4 Plotësimi i vendeve vakante dhe menaxhimi i burimeve njerëzore sipas aftësive profesionale, përshkrimeve sipas pozicionit dhe arsimit të kërkuar, sipas aftësive profesionale, dhe kritereve të përcaktuara në aktet ligjore, nënligjore në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike dhe me Ministrinë .**

**Ky objektivi është realizuar:**

- a) Duke zbatuar procedurat ligjore mbi menaxhimin e burimeve njerëzore në lidhje me legjisllacionin për nëpunësin civil, emërimin, lirim, rekrutimin, regjistrimin e lëvizjes së punonjësve, menaxhimin e dosjeve të personelit dhe dhënies së informacioneve eproreve sipas shkallës së hierarkisë, mbi menaxhimin e burimeve njerëzore. (Raportimi periodik/mujor i informacionit në lidhje me lirimet, emërimet, vlerësimet, masat disiplinore, proceset gjyqësore të nëpunësve civil), duke iu referuar strukturës plan dhe fakt, shpallja e vendeve vakante sipas kritereve, përshkrimeve dhe

arsimit të kërkuar, sipas aftësive profesionale, dhe kritereve të përcaktuara në aktet ligjore, nënligjore në fuqi.

- b) *Nepërmjet Administrimit të sistemit HRMIS*, hedhjes së të dhënave dhe shkresave nga dosja personale fizike në sistemin online,
- c) Në zbatim të ligjit të nëpunësit civil 152/2013, VKM Nr. 833 Datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit, regjistrin qendror të personelit”, VKM Nr. 568 Datë 06.10.2021 “Për miratimin e rregullave mbi kohëzgjatjen e punës edhe të pushimit për punonjësit e administratës shtetërore”,
- d) Rishikimit të dosjeve të personelit duke i azhornuar me regjistrin qendror të personelit dhe sistemin HRMIS,
- e) Ngritjen e nivelit profesional të punonjësve nëpërmjet trajnimeve të detyrueshme dhe trajnimeve të tjera nga programe të ndryshme të organizuar nga ASPA.

Për sa i përket personelit mbi nëpunësit civil për vitin 2024 mbetet vetëm një vend vakant i cili është *Përgjegjësi i Sektorit të kompetencave vendore dhe funksioneve të deleguara, edhe pozicioni i nënprefektit Lushnje(funksionar politik). Jemi në pritje të plotësimit të vendit vakant nga DAP.*

Nga ana tjetër nuk kemi pas asnjë Lëvizje Paralele.

Sa më lart personeli rezulton të jetë pothuajse i plotësuar por edhe i stabilizuar dhe konsiderohet arritje nga Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse sepse ka qenë edhe një ndër objektivat ne vite.

Funksioneve të deleguara, dhe 1 funksionar politik (Nënprefektura Lushnje).

Më konkretisht sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Përshkrimi i Personelit	Plan	Fakt	Vakant
1	Numri i pozicioneve sipas strukturës së miratuar	32	30	2
	Nga të cilët			
2	Numri i pozicioneve të funksionarëve politik sipas strukturës	3	2	1
3	Numri i nëpunësve civil	23	20	1
	Numri i punonjësve në periudhë prove		2	0
	Numri i punonjësve me kontratë(ekselente)		0	
4	Numri punonjësve mbështetës	3	3	0
5	Numri gjithsej i punonjësve për funksionet e deleguara	3	3	0

- a. **Emëruar nga procedura e lëvizjes paralele:** 0 nëpunës civil.  
**Larguar nga procedura e lëvizjes paralele:** 0 nëpunës civil.
- b. **Emëruar nga procedura e pranimit në shërbim civil:** 2 nëpunës civil në periudhë prove.
- c. **Emërim nga VKM për punësimin e ekselentëve:** 0 nëpunës.
- d. **Lirim nga detyra:** 0

**e. Morën statusin e nëpunësit civil: 0 nëpunës.**

*Mbetet objektiv edhe detyrë për shtimin në organikë të një punonjësi IT në Institucion për arsye të domosdoshme të shërbimeve kompjuterike dhe mbarëvajtjen e sistemeve online që përdoren në institucion, bazuar në shkresën e Ministrisë së Brendshme nr.7341/1Prot datë 12.07.2023, “Për njohje dhe zbatim të shkresës me nr.3537prot datë 06.07.2023 të Agjensisë Kombëtare të Shoqërisë së informacionit, në bashkëpunim dhe miratim të ministrisë së linjës dhe plotësimit të vakancës*

f) Ndjekja e detyrave të urdhërit për Autoritet Përgjegjës dhe komunikimi me ILDKPI.  
*-Funksionimi i rregullt i programit EACIDS për plotësimin online të deklaratave të pasurisë për funksionaret politike për ILDKPI dhe dërgimi i raportit vjetor.*




## SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

- ❖ Monitorimi i zbatimit të programit të qeverisë dhe plotësimin e detyrave të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fushën e zhvillimit urban.
- ❖ Përpunimi dhe vlerësimi i informacioneve dhe kërkesave të ardhura nga Institucionet Qëndrore në Nivel Vendor dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.
- ❖ Nxitja dhe kontributi për një ambient më të pastër.
- ❖ Nxitja e programeve në drejtim të përshtatjes me ndryshimet klimaterike.

Objektivat janë realizuar si me poshtë :

- *Ndjekja e zbatimi i Planeve të Përgjithshme Vendore për gjashtë bashkitë e qarkut : Fier, Lushnje, Mallakastër, Divjakë, Patos, Roskovec.*




### QARKU FIER



- ❖ **Kontrollit të Zhvillimeve në Territor**

L. "11 Janari" Rr. "Ramis Aranitasi" Fier, <http://prefektifier.gov.al>, [prefekti.fier@mb.gov.al](mailto:prefekti.fier@mb.gov.al)

Është kryer procesi i kontrollit të zhvillimeve në territor me Njësitë e Vetqeverisjes Vendore për vitin 2024. Bazuar në Ligjin Nr. 107/2014“Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorrit” ky raportim mbyllet deri më 25 Mars të vitit pasardhës dhe është raportuar botimin në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorrit, nga ana e Njësive të Vetqeverisjes Vendore!



Institucioni	Leje infrastrukture	Deklarata paraprake	Leje ndërtimi	Leje Zhvillimi	Leje shtyrje afati	Njoftim për fillim punimesh	Leje për ndryshim projektesh	Çertifikatë përdorimi
Fier	3	42	28	30	0	2	3	4
Lushnje	1	100	71	38	1	0	0	29
Mallakastër	2	4	3	3	1	3	0	5
Divjakë	2	33	23	17	1	10	2	6
Patos	3	14	5	3	0	2	0	0
Roskovec	15	17	7	6	0	1	0	4
<b>TOTAL</b>	<b>26</b>	<b>210</b>	<b>137</b>	<b>97</b>	<b>3</b>	<b>18</b>	<b>5</b>	<b>48</b>

❖ **Aktiviteti i Dites së Tokës 22 Prill 2024 !**

U miratua programi i Ditës së Tokës me temë

**“Të reduktojmë ndotjen nga plastika ” me Nr.Prot 413 Datë 11.04.2024 :**

- *Qyteti pa makina në fashën orare 8.00-12.00 për Qarkun Fier*
- *Fletpalosjeve të punuar nga Sektori i Zhvillimit Urban .*
- *Aksion pastrimi nga Njësitë e Vetqeverisjes Vendore*

Programi u ndoq dhe u zbatua në Rang Qarku

❖ **Ndjekja e Aksionit të Pastrimit për gjithë Qarkun Fier !**

Në kuadër të nismës së Kryeministrit “ SHQIPËRIA E PASTËR”, me Urdhër të Prefektit Nr.49 datë 25.11.2021 është ngritur grupi i punës ndërinstitucional për marrjen e masave për pastrimin dhe higjienizimin e mjedisit nga mbetjet në Qarkun Fier! Për vitin 2024 Sektori i Zhvillimit Urban vijon koordinimin e aksionit të pastrimit , shoqëruar me planifikime javore dhe raportime mujore .

*Planifikimet Javore janë përmbledhur në rang qarku dhe dërguar në grupin ehatsapp në Planin Kombëtar të Pastrimit.*

Janë kryer **Monitorime në terren** mbi zbatimin e Planit Javor të Pastrimit .

*Problematike është Bashkia Mallakastër, si në pastrim ashtu edhe në depozitim e mbetjeve në Impiantin e Përpunimit të Mbetjeve Fier!*

**Raporti Mujo**r përmbledhës është dërguar në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit!


*Problematikë mbetet kultura e përgjithshme mbi mbajtjen pastër të mjedisit sidomos në zonat rurale, ku vihet re që ndotja me e madhe është në zonën afër koshave të mbeturinave : koshat bosh, territori rreth koshave i ndotur !*

❖ **Buxheti i Pastrimit 2025**


Njësia e Vetqeverisjes Vendore	Buxheti i Pastrimit 2021	Buxheti i Pastrimit 2022	Buxheti i Pastrimit 2023	Buxheti i Pastrimit 2024	Buxheti i Pastrimit 2025
Bashkia Fier	185.836.000	186.307.812	235.855.353	272.318.972	186.286.000
Bashkia Lushnje	83.454.000	109.887.000	111.649.522	115.876.745	99.193156
Bashkia Mallakastër	12.786.675	43.374.143	48.621.551	50.420.551	48.584.236
Bashkia Divjakë	25.292.820	40.093.484	112.691.790	115.521.105	42.205.769
Bashkia Patos	34.193.648	35.593.648	41.167.487	53.388.366	55.737.667
Bashkia Roskovec	31.617434	37.493.422	45.330.221	50.999.686	57769.670

L. “11 Janari” Rr. “Ramis Aranitasi” Fier, <http://prefektifier.gov.al>, [prefekti.fier@mb.gov.al](mailto:prefekti.fier@mb.gov.al)

## BUXHETI I BASHKIVE NË PASTRIM




Njësia Vetqeverisjes Vendore	TOTAL BUXHET 2025	Buxheti i Pastrimit 2025	%NDAJ TOTAL BUXHET
Bashkia Fier	1.115.032.487	186.286.000	1.67 %
Bashkia Lushnje	1.903.651.654	99.193.156	5.21 %
B. Mallakastër	898.112.260	48.584.236	5.40 %
Bashkia Divjakë	1.386.966.547	42.205.769	3.04 %
Bashkia Patos	676.666.231	55.737.667	8.23 %
Bashkia Roskovec	694.881.799	57.769.670	8.31 %



## ❖ Depozitimi i mbetjeve urbane

Bashkia	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qer shor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	SasiaTot (ton)
Fier	1688	1687	1792	1992	1703	2050	2108	2586	2420	2316	2093	2338	24779
Lushnje	1059	940	1082	1049	1125	1059	1300	1417	1197	1242	1124	1284	13882
Mallakastër	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Divjakë	390	327	432	444	459	457	558	645	493	470	419	516	5610
Patos	320	231	317	269	199	232	68	152	166	245	260	259	2724
Roskovec	223	207.4	211	219.8	233.6	187.3	250.3	272.1	250.36	237.02	220.08	214.16	2726.46



**v.o : Bashkia Mallakaster nuk depoziton mbetjet ne Impiantin e Përpunimit te Mbetjeve Fier**

## ❖ Monitorimi i përdorimit dhe tregtimit të qeseve plastike

Në kuadër të Task-Forcës së ngritur me Urdhër të Kryeministrit Nr.190 datë 15.11.2022 “Për përbërjen, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Task-Forcës “Për qeset plastike” dhe bazuar në kërkesën me Nr. 1167 Prot. Datë 16.02.20230 “Për bashkëpunim dhe koordinim me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”, është ngritur një grup pune me përfaqësues nga çdo njësi, për të koordinuar procesin. Janë mbledhur raportimet **javore** dhe **mujore** në menyrë periodike. Afati i fundit i parashikuar për funksionimin e kësaj task-force ishte data 1 Janar 2025.

## ❖ Ndjekja e Mbledhjeve të Komitetit të Menaxhimit të Zonës së Mbrojtur : Parku Kombëtar *Divjakë Karavasta*


Janë mbajtur **2** (dy) Mbledhje të Komitetit të Menaxhimit të Zonës së Mbrojtur Parku Kombëtar Divjakë-Karavasta:

- Datë 07.05.2024 në ambientet e Prefektit të Qarkut Fier.
- Datë 16.10.2024 ne ambientet e AdZM Fier, Divjakë

**Problematika :**


- dezinfektimi për të cilin është mbajtur kontakt me Ministrinë dhe Agjencinë e Shëndetit Publik për ta realizuar në kohën e duhur!
- uljen e saisë së peshkut është adresuar në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Janë ndjekur simpoziumet dhe aktivitetet e Agjencise Kombëtare te Zonave te mbrojtura ne lidhje me Parkun e Lumit Vjosa .




❖ Shtimi i sipërfaqeve të gjelbra në rang Qarku !

BASHKIA	SIPËRFAQE TË GJELBRA TË SHTUARA (m <sup>2</sup> )
<b>FIER</b>	<b>18200</b>
<b>LUSHNJE</b>	<b>43408</b>
<b>MALLAKASTËR</b>	<b>0</b>
<b>DIVJAKË</b>	<b>0</b>
<b>PATOS</b>	<b>9750</b>
<b>ROSKOVEC</b>	<b>1750</b>



❖ Investimet në Qarkun Fier

BASHKIA	INVESTIMET NE QARKUN FIER (me tvsh)
<b>FIER</b>	<b>175.110.830</b>
<b>LUSHNJE</b>	<b>160.978.871</b>
<b>MALLAKASTËR</b>	<b>91.325.589</b>
<b>DIVJAKË</b>	<b>186.233.756</b>
<b>PATOS</b>	<b>173.721.561</b>
<b>ROSKOVEC</b>	<b>100.324.549</b>
<b>Total Qarku Fier</b>	<b>887.695.156</b>



Institucioni	Nr	Investimi	Buxheti Shtetit	Buxheti Bashkisë
<b>Bashkia Fier</b>	1	Ndërtim i Kolektorit Kuz-Bulevardi Jakov Xoxa( Rrethrotullimi Ura e Sheqit-Rrethrotullimi i Sharrës)	100%	
	2	Ndërtimi i KUZ-së së lagjes “Afrim”, punime riparimi, mirëmbajtjes dhe reabilitimi të infrastrukturës së ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytja	100%	
	3	Punime riparimi, mirëmbajtjes dhe reabilitimi të infrastrukturës së ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytja (Argjinatura për mbrojtjen nga Lumi Vjosa L-1448ml)	100%	
	4	Bankina e krahut të majtë te dega e Martinës zona e Ferrasit	100%	
	5	Ndërtim depo uji V-200 <sup>3</sup>	100%	
	6	Rikonstruksion i rrugës Celigrad (Hekurudha-Bypass Fier)	100%	
	7	Infrastruktura Bashkiake MIP V(Stacioni Pompimit Kafaraj) Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare “Naim Frashëri” dhe shtesë anësore e palestër	100%	
<b>Bashkia Lushnje</b>	1	Reabilitimi I shkollës Jani Nushi(Grand I kushtëzuar)	100%	
	2	Mobilim i shkollës Jani Nushi (Grand I kushtëzuar)	100%	
	3	Blerje pajisje/Invest të tjera Bashkia(Grand I pakushtëzuar)	100%	
	4	Invest, superviz, projekttime, kolaudime, investime të tjera.	100%	
	5	Urbanizmi i bllokut të banimit në dushk sector+mbikëqyrja	100%	
	6	Rindërtim i rrugës Lasgush Pogradeci aksi pas përroit	100%	
	7	Punime ndërtimi në territorin e varrezave	100%	
	8	Urbanizimi i bllokut të banimit të banimit në lagjen Saver	100%	
	9	Ndërtim i murit mbajtës përgjatë pallateve L “KongresiLushnjes”	100%	
	10	Reabilitim i godinës së palestrës në Krutje	100%	
	11	Reabilitim Biblotekës “Të rinjtë për të rinjtë”	100%	
<b>Bashkia Mallaka stër</b>	1	Ndërtim i shkollës Gjok Doçi	85%	15%
	2	Punime për reabilitimin e digës së rezervuarit të Gadurovës	100%	
	3	Rikonstruksion i rrjetit shpërndarës të qytetit të Ballsh	100%	
	4	Ndërtim linje trasmetimi rrjeti i jashtëm i ujësjellësit Rajonal (nga burimi Poçemit)	100%	
<b>Bashkia Divjakë</b>	1	Ndërtimi i shkollës 9-vjeçare “Ismail Veizi” Babunjë	80 %	20%
	2	Shkolla rikonstruksion+ Ndërtim palestere Remas (MAS)	100%	
	3	Ndërhyrje emergjente nga erozioni dhe sistemi ujërave në fshatin Grabjan, Kryekuq dhe Zharrec.	100 %	
	4	Mbrojtje Lumore në lumin Shkumbin. Prita nivelngritëse në kanalën kullues kryesor K 3-4 Bedat (AKMC +M.Bujq)		
	5	Bazë materiale për mobilimin e shkollave të arsimit bazë dhe të mesëm (MAS)	100 %	
	6	Përmirësim i shtresave rrugore në aksin Spolatë-Grabjan, Gërmenj-Bicukas, Babunj-Adriatik (F.SH.Zh)	100 %	
	7	Blerje çakull	100%	
	1	Rikonstruksion i shkollës “Muhamet Shehu” dhe ndërtim i palestrës	90%	10%
	2	Ndërtim muri mbajtës me struktura metalike për përforsim	100%	

<b>Bashkia Patos</b>		bazamenti dhe rikonstruksion i rrugës së dëmtuar nga rrëshqitja e dherave	AKMC	
	3	Rikonstruksion i magjstralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të ujësjellsit të qytetit Patos Loti 2,	100% AKUK	
	4	Rikualifikimi i fasadave të pallateve, blloku i parë (FSHZH)	100%	
<b>Bashkia Roskovec</b>	1	Kompleksi i terreneve sportive të hapura dhe të mbyllura në shkollën “5 Dëshmorët”, Suk 1	85 %	15%
	2	Fuqizimi I stacionit të pompimit të ujitjes nga Lumi Seman, Zona Suk, Bashkia Roskovec	100%	
	3	Mbrojtje nga Lumi Seman në krahun e majtë, BashkiaRoskovec	100%	
	4	Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara	50%	50%
	5	Rritja e sigurisë së digës dhe përmirësimi i aftësive ujëmbledhëse të rezervuarit të Kurjanit	100%	
	6	Sistemimi i shkarjes së varrezave Kurjan	100%	



## **SEKTORI I PLANIFIKIMIT DHE MBROJTJES CIVILE**

Institucioni i Prefektit, nëpërmjet Sektorit të Planifikimit dhe Mbrojtjes Civile, ka koordinuar punën midis ekspertëve dhe Njësive të Vetëqeversijes Vendore për hartimin e dokumentit të Strategjisë Vendore për Zvogëlimin e Riskut dhe Planet Vendore për Emergjencat Civile, për gjashhtë bashkitë e qarkut Fier.

### **❖ Sigurimi i funksionimit të sistemit të paralajmërimit të hershëm, monitorimit dhe njoftimit në nivel qarku**

Për realizimin e këtij objekti nga Sektori i Planifikimit dhe Mbrojtjes Civile janë mbajtur kontakte të përditshme me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe Strukturat Vendore të sistemit të mbrojtjes civile, duke përcjellë çdo ditë të dhëna që vinë nga IGJEO apo SHMU. Nga strukturat e Mbrojtjes Civile ka funksionuar zinxhiri i paralajmërimit të hershëm

### **❖ Konsolidimi i performancës së strukturave vendore të mbrojtjes civile**


Objekti është realizuar nëpërmjet organizmit të takimeve të përbashkëta dhe gjithëpërfshirëse, ku vlen të theksohen aktivitetet e organaizuara nga AKMC, në nivel vendor dhe qendror, me pjesëmarrje të strukturave qendrore dhe vendore të M. Civile ku janë trajtuar tematika si:

- “Moduli i trajnimit bazë të Mbrojtjes Civile për strukturat e Mbrojtjes Civile në Nivel Qarku dhe Bashkie”, organizuar më datë 21 - 22 Maj 2024 në Fiër.
- “Stërvitja Funksionale “Pishë - Poro 2024” për strukturat e Mbrojtjes Civile në Nivel Qarku dhe Bashkie”, organizuar më datë 02 - 03 Korrik 2024 në Fier, ku në fokus të modulit ishte rasti i zjarrit të ndodhur në Pishë Poro gjatë vitit 2023.
- Takimeve të organizuar nga Komisioni i Mbrojtjes Civile, Qarku Fier, etj.

### **1. Detyra të tjera të realizuara:**

- Përditësimi i dosjes me aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e Mbrojtjes Civile.
- Rifreskimi i planit të masave për sezonin vjeshtë - dimër dhe pranverë - verë 2024.
- Përditësimi i bazës së të dhënave mbi situatat e zjarreve në nivel qarku.
- Pjesëmarrje dhe përfaqësim I institucionin në takime dhe aktivite në fushën e mbrojtjes civile.
- Ndjekje dhe zbatim i detyrave që rrjedhin nga urdhrat e brendshëm të institucionit
- Hartimi dhe konceptimi i shkresave, informacioneve dhe raporteve ditore, javore dhe mujore.
- Monitorimi në terren i hidrovoreve, digave dhe argjinaturave lumore, etj.

## 2. Emergjencat e ndodhura nga zjarret



Gjatë vitit 2024, nga raportimet e strukturave vendore të mbrojtjes civile dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, janë evidentuar 252 raste zjarri nga të cilat: 42 raste në objekte, 8 raste në ekonomi pyjore, 38 raste në ullishte, 147 raste në shkurre dhe ferra, 8 raste në depozita bari, 9 raste në automjete.

### Shpërndarja e zjarreve

Emërtimi NJ.V.Q.V	Raste Gjithsej	Objekte			Sipërfaqet e veshura me bimësi						Depozita bari për blektorinë	Automjete
		Rastet	Private	Publike	Rastet	Pyje		Ullishte		Sip. të djerra		
						Rastet	Sipërfaqe Djegur (në ha)	Rastet	Sasia e Djegur (në rrënjë)			
Qarku Fier	252	42	42	0	193	8	269.93	38	6844	147	8	9
Bashkia Fier	45	13	13	0	30	2	55.15	11	3195	17	2	0
Bashkia Lushnje	75	11	11	0	60	1	44	5	1602	54	3	1

Bashkia Mallakaster	32	2	2	0	29	3	165	7	1258	19	0	1
Bashkia Patos	55	8	8	0	42	0	4.15	10	300	32	1	4
Bashkia Divjake	21	4	4	0	15	1	0.83	2	50	12	1	1
Bashkia Roskovec	24	4	4	0	17	1	0.8	3	439	13	1	2

#### Konstatime:

- Në raport me vitin 2023 ka një tendencë në rritje të numrit të përgjithshëm të rasteve të zjarreve, kryesisht në territorin e bashkisë Lushnje e më konkretisht në sipërfaqet me hamullore.
- Repartet e MZSH-ve, gjatë veprimtaisë së tyre reaguese, edhe pse është bërë shumë punë, përsëri kanë mangësi, si në sasi ashtu dhe në cilësi të kapaciteteve teknikë e logjistike të tyre.
- Mungojnë investime në infrastrukturën rrugore për zonat malore apo kodrinore të veshura me ekonomi pyjore, ullishte apo bimësi të egër duke vështirësuar edhe më shumë punën e shërbimit zjarrfikës.

### 3. Emergjencat dimërore

Gjatë vitit 2024, në territorin e Qarkut Fier gjatë sezonit dimëror nuk ka pasur situata problematike të shkatëruara nga reshjet si:

- Përmbytje
- Rrëshqitje dherash
- Bllokime të akseve rrugore
- Ndërprerje të furnizimit me uji të pijshëm.

Gjatë sezonit dimëror si pasojë kushteve atmosferike janë raportuar këto problematika:

- Ndërprerje të përkohshme të energjisë elektrike në disa zona rurale
- Prezenc e ujrave sipërfajësore në toka bujqësore, në disa zona (në varësi të sistemit të kullimit)

### 4. TË TJERA

#### **VEPRIMTARIA “PËR LUFTËN KUNDËR KANABISIT”**

Për luftën kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit, ka vijuar ndjekja e veprimtarive të punës nga strukturat vendore si me bashkitë dhe Degët Territoriale dhe në mënyrë të veçantë me strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, ku për vitin 2024, janë evidentuar 2 raste të kultivimit të kanabisit:

- Një rast në territorin e bashkisë Fier, ku janë gjetur dhe asgjësuar 305 bimë të dyshuara kanabis sativa. Për këtë rast janë arrestuar dy shtetas.
- Një rast në territorin e bashkisë Patos, ku janë gjetur dhe asgjësuar 8 bimë të dyshuara si kanabis sativa.
- Në bazë të të dhënave të administruara nga Komunikata e Policisë, është përditësuar baza e të dhënave për rastet e kultivimit të kanabisit.

Në kuadër të luftës kundër kultivimit të kanabisit gjatë muajit Shkurt, në Institucionin e Prefektit është zhvilluar një takim sensibilizues me pjesëmarrës të Drejtuesve të strukturave vendore, pjesë e “Task-Forcës Vendore”. Gjithashtu, Institucioni i Prefektit ka marrë pjesë edhe në takimet sensibilizuese të organizuara nga Komisariati i Policisë Fier, në Njësitë Administrative të Bashkisë Fier.

## **OBJEKTIVAT PËR VITIN 2025 PËR INSTITUCIONIN E PREFEKTIT TË QARKUT FIER**

- ❖ **Rritja e standardit të verifikimit të ligjshmerise se akteve të njesive të veteqeverisjes vendore, verifikimi i ligjshmerise i të cilave është në kompetencë të Prefektit.**

Veprime për zbatimin e objektivit:

- Verifikimi ligjor i akteve të NJVQV-ve në kompetencë të Prefektit, nga ana e sektorit juridik referuar kuadrit ligjor në fuqi. Mbatja e kontakteve të vazhdueshme me sekretaret e keshillave bashkiak.
- Zbatimin me përgjegjësi të detyres së verifikimit të ligjshmerise se akteve të NJVQV-ve nga sektori juridik. Ndjekja e shkallës hierarkike në përmbushjen e kësaj detyre. Dhenia e konsulencës juridike sekretareve të keshillave, dërgim i shkresave sqaruese NJVQV-ve kur paraqitet nevoja.

- ❖ **Përmbushja me efikasitet dhe përgjegjësi ligjore e kompetencës së Prefektit për sa i përket verifikimit në vend të ligjshmerise se akteve me karakter normativ të NJVQV-ve.**

Veprime për zbatimin e objektivit:

- Zbatimi brenda afateve ligjore dhe me standard juridik i kontrollit periodik i verifikimit në vend të ligjshmerise se akteve normative të NJVQV-ve.
- Urdhëri i prefektit në fillim të vitit 2025 për verifikimin në vend të ligjshmerise. Verifikimi në vend në muajt Mars, Qershor, Shtator, Dhjetor 2025.
- Rritja e standardit ligjor të procedurës së verifikimit në vend të akteve me karakter normativ të NJVQV.

- ❖ **Mbrojtja e interesave ligjore të Institucionit.**

Veprimet për zbatimin e objektivit:

- Ndjekja e proceseve gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit me përgjegjshmëri, efikasitet dhe në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi.

- Leshimi i autorizimit te prefektit per perfaqesim ne gjykate nga sektori juridik.Hartimi i kërkesëpadisë, kundërpadisë, deklaratës së mbrojtjes, prapësimeve, ankimeve, ankimeve të veçanta, rekursit si dhe kryerja e çdo veprimi procedural të nevojshëm

❖ **Rritja e standartit ligjor te hartimit te shkresave nga administrata.**

Veprimet për zbatimin e objektivit”

- Përmirësimi i njohurive juridike gjate përmbushjes se detyrave të administrates.
- Njohja ne kohe i administrates me ndryshimet ligjore. Hartimi i materialeve shpjeguese për administratën apo mbajtja e seminareve me tematika të caktuara me qellim kualifikimin e administratës kur kjo kërkohet nga administrata apo titullari

❖ **Rritja e bashkëpunimit dhe ndërtimi i marrëdhënieve me Njësitë e Veteqeverisjes Vendore me qëllim njohjen dhe ushtrimin e kompetencave nga ana e tyre dhe evidentimin e problemeve për të cilat janë të interesuara NJVQV-të në raport me Organet e Qeverisjes Qëndrore.**

Veprimet për zbatimin e objektivit:

- Komunikim i vazhdueshëm me organet e NJVQV.Evidentimi i funksioneve dhe kompetencave të NJVQV.Ndjekja dhe monitorimi i ushtrimit nga ana e NJVQV të veprimtarisë së tyre lidhur me këto funksione dhe kompetenca.Dhënia e ndihmes proactive në formën e kërkuar, për realizimin e funksioneve dhe kompetencave të tyre
- Njohje më e mire nga ana e NJVQV-ve e funksioneve dhe kompetencave nga ana e tyre si dhe evidentim më i lartë i problematikave të NJVQV-ve kundrejt organeve të qeverisjes qëndrore

❖ **Zhvillimi i marrëdhënieve, midis Institucioneve të pavarura dhe Institucioneve të varësisë në Qark si dhe Institucioneve qendrore të qeverisë , Ministritë, KM, etj me qëllim koordinimin e tyre për realizimin e objektivave qeveritare dhe strategjive të miratuara në drejtim të funksioneve në fushën e sigurise publike, fushën e zhvillimit ekonomik vendor, ne fushën e bujqësisë, natyrës dhe biodiversitetit, në fushën e kulturës, sportit, shërbimeve argëtuese etj, si dhe në drejtim të kompetencave të deleguara pranë pushtetit vendor duke adresuar cdo pengesë dhe problematikë në zbatimin e detyrave.**

Veprimet për zbatimin e objektivit:

- Komunikim i vazhdueshëm me organet qendrore dhe vendore në forma të ndryshme për evidentimin e problematikave,• Në rast të kërkesave apo konflikteve institucionale midis qeverisjes qëndrore në nivel vendor dhe NJVQV-ve ndërhyr në realizimin e kërkesave apo zgjidhjen e konflikteve
- Në përfundim të veprimtarisë hartohet një raport mbi problematikën e ngritur i cili mund të shërbejë për unifikimin e marrëdhënieve në të gjitha Njësitë e Vetqeverisjes Vendore

- ❖ . Ndjekja dhe monitorimi i veprimtarive të Institucioneve qëndrore dhe Vendore për mbarëvajtjen e sezonit turistik 2022, ndjekja e detyrave nga Task-Forca të vecanta për sezonin turistik në Qark si dhe ndjekjen dhe realizimin e detyrave të Komitetit Rajonal të Turizmit. Ndjekja e problemeve të sigurisë, të higjenës dhe të shëndetësisë në plazhe dhe në zona të tjera turistike.

Veprimet për zbatimin e objektivit:

- Parashikimi në plan pune i detyrave të sektorit përkatës. Zbatimi I afateve gjatë kryerjes së detyrave. Azhornimi i vazhdueshëm me ndryshimet e reja ligjore.
- Realizimi me sukses I sezonit turistik veror dhe mbarëvajtja e veprimtarive të ndërmara nga Institucionet gjatë sezonit.

❖ **. Ndjekja e veprimtarisë së organeve vendimmarrëse të NJVQV-ve, akteve normative të nxjerra prej tyre, nivelin juridik dhe funksional, nivelin e komunikimit me publikun dhe transparencën. Koordinimi i punës ndërmjet Institucioneve rajonale për zhvillimin e konsultimeve me NJVQV-të për politikat, legjislacionin dhe normat që ndikojnë drejtëpërdrejtë ne realizimin e funksioneve të NJVQV-ve.**

Veprimet për realizimin e këtij objektivit:

- Prefekti i Qarkut do të kërkojë NJVQV ta vërë në dijeni për gjithë procesin e hartimit të projektbuxhetit vjetor dhe afatmesëm duke marrë pjesë në konsulta për realizimin e hartimit të tij, Institucioni i Prefektit të Qarkut do të kujdeset që procedurat kyçe të hartimit të projektbuxhetit të kalojnë nga konsultat me publikun dhe grupet e interesit duke garantuar kështu transparencën e tyre dhe pjesëmarrjen e publikut në procesin e hartimit.

❖ **Përdorimi dhe menaxhimi me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet i fondeve buxhetore nëpërmjet rritjes së përgjegjësisë mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm.**

Veprimet për realizimin e këtij objektivit:

- Hartimi i një plani të detajuar të burimeve financiare sipas klasifikimit buxhetor, bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.
- Studimi i hollësishëm i nevojave dhe kërkesave sipas sektorëve për fonde për vitin 2025, duke bashkëpunuar me sektorët, në respektimin e parimit të transparencës, ligjshmërisë, shmangien e shpërdorimit të fondeve, keqpërdorimit dhe vjedhjes së pasurisë së institucionit.
- Bashkëpunimi me ministrinë e linjës dhe departamentin e Administratës Publike.
- Mirëmbajtja e aktiveve të Institucionit, rritja e përgjegjësisë menaxheriale të Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

❖ **Permiresim i kushteve të punës**

Veprimet për realizimin e këtij objektivit:

- Përmirësimi i kushteve të punës, në këndvështrimin jetësor dhe atë funksional.
- Kompletimi i zyrave me orenditë e nevojshme.
- Pajisja me bazë materiale të përditshme.
- Standardizimi i sistemimit të dokumentacionit në zyra dhe kujdesit për ambientin e punës.
- Zbatimi i kodit të etikës në punë j,
- Mirëmbajtja e aktiveve të Institucionit, rritja e përgjegjësisë menaxheriale të Sektorit të Financës dhe shërbimeve mbështetëse.

❖ **Arkivimi i dokumenteve**

**Veprimet për realizimin e keëtij objektivi:**

- Standardizimi dhe sistemimi i dokumentacionit arkivor të Institucionit të Prefektit të Qarkut Fier
- Standardizimi i mënyrës së hartimit të urdhrit, vendimit, udhëzimit, trajtimit të kërkesave ankesave, kthim përgjigjeve etj.
- Zbatimi me rigorozitet i gjuhës shqipe dhe përmirësimit të mënyrës së formulimit të dokumentit.
- Përpunimi dhe dorëzimi i dokumentacionit arkivor në vite.
- Përmirësimi i kushteve të ambientit të përpunimit të dokumentacionit shkresor ditor të arkivit.

❖ **Ndjekja dhe zbatimi i procedurave ligjore mbi menaxhimin e burimeve njerezore**

**Veprimet për realizimin e këtij projekti:**

- Njohja dhe zbatimi i legjislacionit për nëpunësin civil, emërimin, lirim, rekrutimin, regjistrimin e lëvizjes së punonjësve, menaxhimin e dosjeve të personelit dhe dhënies së informacioneve eprorëve sipas shkallës së hierarkisë,
- (Raportimi periodik/mujor i informacionit në lidhje me lirimet, emërimet, vlerësimet, masat disiplinore, proceset gjyqësore të nëpunësve civil), në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike dhe me Ministrinë e Brendshme.
- *Administrimi i HRMIS*, hedhja e të dhënave dhe shkresave nga dosja personale fizike në sistemin online.

❖ **Raportimi dhe përditësimi i pronave të paluajtshme sipas listës së inventarit të pronave për Institucionin e Prefektit Qarkut Fier**

**Veprimet për realizimin e këtij projekti:**

- VKM Nr. 28, datë 27.1.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve”,
- Urdhëri i Ministrit të Brendshëm Nr. 44, datë 11.4.2023 “Për zbatimin e VKM Nr. 28, datë 27.1.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve.”

❖ **Monitorimi I zbatimit të programit të qeverisë dhe plotësimi I detyrave të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fushën e zhvillimit urban!**

**Veprimet për realizimin e këtij objektivi**

- Zbatimi i Programit të Qeverisë 2021-2025
- Monitorimi i zbatimit të Planeve të Përgjithshme Vendore për të gjashtë njësitë e vetqeverisjes vendore të Qarkut Fier!

❖ **Dhënie konsulencë dhe koordinim I punës me Njësitë e Vetqeverisjes Vendore, Agjencinë e Planifikimit të Territorrit dhe institucionet e tjera shtetërore në qark, për çështje dhe problematika që hasin në procesin e planifikimit të territorit!**

### **Veprimet për realizimin e objektivit:**

- Përmirësimi i procesit të planifikimit për territorin e qarkut.
- Komunikimi periodik me njesite e Vetqeverisjes vendore ose përgjigje ndaj kërkesave të tyre sipas mënyres së përcaktuar me ligj.
- Koordimi i punës dhe respektimin e hierarkisë institucionale me synimin e zhvillimit të territorit sipas mënyres së përcaktuar me ligj.

### **❖ Nxitja e programeve në drejtim të përshtatjes me ndryshimet klimaterike dhe një zhvillim të qëndrueshëm Veprimet për realizimin e objektivit”**

- nxitja e një zhvillimi të qëndrueshëm që do të rezistojë ndryshimeve klimaterike dhe një zhvillimi afatgjatë .
- Ndjekja e trainimeve dhe direktiva të qeverisë për t'u ardhur në ndihmë njesive të vetqeverisjes vendore
- Ndjekja e direktivave të programit të qeverisë dhe botimet e Agjencisë së Mjedisit

### **❖ Hartimi dhe miratimi i Planit për Emergjencave Civile, në nivel qarku Veprimet për realizimin e objektivit:**

- **Sigurimi I** një reagim të shpejtë, efikas dhe të koordinuar për të menaxhuar pasojat e një situatë emergjente dhe rimëkëmbjen nga çdo ndikim negativ si pasojë e emergjencave apo fatkeqësive që mund të prekin jetën e njerzëve, gjëne e gjallë, pronën, trashëgimin kulturore apo mjedisin në qarkun Fier:
- Bashkëpunim dhe shkëmbim informacioni me grupin e punës të përzgjedhur nga UNDP në kuadër të projektit RESEAL dhe strukturat vendore të Mbrojtjes Civile për hartimin e Planit për Emergjencat Civile, Qarku Fier.
- 2. Hartimi i Urdhërit të Prefektit për miratimin e planit.
- Dërgimi i planit për njohje strukturave vendore dhe qendrore të sistemit të Mbrojtjes Civile.

### **❖ Sigurimi i funksionimit të sistemit të pralajmërimit të hershëm, monitorimit dhe njoftimit në nivel qarku**

Do të mbështetet në :

Sigurimin i një informacion për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, duke iu mundësuar institucioneve dhe komunitetit të rrezikuar, marrjen e masave të nevojshme për zvogëlimin e pasojave që mund të ndodhin si pasojë e një ngjarje emergjente të mundshme

Veprimet për realizimin e objektivit:

- Bashkëpunimi me institucionet dhe strukturat e sistemit të mbrojtjes civile që identifikojnë, mbledhin, përpunojnë, analizojnë, si dhe komunikojnë të dhënat që kanë të bëjnë me rreziqet e menjëhershme dhe ato të pritshme të cilat përbëjnë ose mund të kthehen në risqe për komunitetin.
- Njoftimi menjëherë Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile lidhur me dukuri e ngjarje, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, të evidentuara ose të mundshme për t'u shfaqur në një periudhë kohe të shkurtër, të cilat përbëjnë ose mund të kthehen në risqe për komunitetin.



❖ **Organizimi i fushatave sensibilizuese, pjesmarrja në aktivitete apo trajnime në fushën e mbrojtjes civile**

Do të mbështetet në:

Rritja e ndërgjegjësimit të qytetareve në raport me mbrojtjen civile si dhe rritja profesionale brenda fushës së përgjegjësisë për nëpunësit e sektorit.

Veprimet për realizimin e objektivit:

- Organizimi i aktiviteteve në datat e shënuara që kanë lidhje me mbrojtjen civile, në bashkëpunim me strukturat vendore të MC. DAR apo edhe AKMC.
- Përgatitja e një materiali në poër-point dhe prezantimi I tij në ambiente publike, pranë njësive administrative apo institucioneve arsimore në qarkun Fier.
- Pjesmarrja e nëpunësve në trajnime apo aktivitete të organizuara nga ASPA apo organizma të tjera, në fushën e mbrojtjes civile.

